


 2025



ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE PËRMES *projekteve*

Udhëzues për mësuesit e gjuhës shqipe dhe të letërsisë



Web:
www.ascap.edu.al

Tiranë, 2025

A photograph of a classroom with several students sitting at desks, writing in notebooks. The image is overlaid with a semi-transparent blue filter. The students are focused on their work, and the desks are arranged in rows.

Koordinoi: Erida Koleci



PËRMBAJTJA

HYRJE	5
1. PËRKUFIZIMI DHE KLASIFIKIMI I PROJEKTEVE	7
1.1. Çfarë janë projektet?	7
1.2. Çfarë janë projektet lëndore?	8
1.3. Çfarë janë projektet ndërlëndore?	9
1.4. Llojet e projekteve (kërkimore, krijuese, praktike, prezantuese etj.)	10
2. QËLLIMET E PROJEKTEVE	11
3. PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PROJEKTEVE	12
3.1. Si përzgjidhen temat e projekteve?	12
3.2. Si përshtaten projektet me moshën dhe me nivelin e nxënësve?	15
3.3. Hapat e zhvillimit të projekteve	16
4. ROLI I MËSUESIT DHE I NXËNËSVE NË ÇDO FAZË TË PROJEKTEVE	21
5. SHEMBUJ TEMASH PËR PROJEKTE	23
5.1. Projekte lëndore	23
5.2. Projekte ndërlëndore	24
6. VLERËSIMI I PROJEKTEVE	26
6.1. Rëndësia e vlerësimit të procesit	26
6.2. Kriteret e vlerësimit të projekteve	29
7. SUGJERIME PËR MËSUESIT	33
8. MJETET DHE BURIMET NDIHMËSE	35
8.1. Mjete digjitale për projekte shkollore	35
8.2. Burime dhe materiale të tjera të dobishme	41





8.3.	Parime për përzgjedhjen e mjeteve	41
9.	FORMATI I PLANIT TË NJË PROJEKTI.....	42
10.	MODELE PLANE PROJEKTESH	43
10.1.	Model projekti për klasën e gjashtë.....	43
10.2.	Model projekti për klasën e shtatë.....	51
10.3.	Model projekti për klasën e tetë.....	63
10.4.	Model projekti për klasën e nëntë	70
10.5.	Model projekti për klasën e dhjetë	77
10.6.	Model projekti për klasën e njëmbëdhjetë	89
10.7.	Model projekti për klasën e dymbëdhjetë	97
10.8.	Model projekti për klasën e dymbëdhjetë	84
	BIBLIOGRAFIA.....	104





HYRJE

Në ditët tona, arsimi nuk kufizohet më vetëm te transmetimi i njohurive, por synon edhe t'u krijojë mundësi nxënësve të zhvillojnë kompetenca që janë të transferueshme dhe që do t'u shërbejnë gjatë gjithë jetës. Ai i përgatit nxënësit për të qenë të aftë të përshtaten me ndryshimet, të mendojnë në mënyrë të pavarur, të marrin vendime të drejta dhe të zgjidhin situata të reja. Kjo kërkon që ata të jenë aktivë, të ushtrojnë mendimin kritik e krijues, të hulumtojnë, të bashkëpunojnë dhe të dinë si t'i përdorin njohuritë në kontekste të ndryshme. Për këtë arsye, kurrikula që bazohet në kompetenca, e vendos nxënësin në qendër të procesit mësimor, duke i krijuar mundësi të angazhohet plotësisht dhe të marrë përgjegjësi për të nxënit e tij. Përveç ndërtimit të njohurive të reja, ajo synon zhvillimin e aftësive të rëndësishme si zgjidhja e problemeve, menaxhimi i konflikteve, komunikimi, bashkëpunimi dhe vetëmenaxhimi, të cilat janë të domosdoshme për të pasur sukses në jetë dhe në shoqëri.


Projektet janë një nga format më të dobishme për të realizuar këtë qëllim. Përmes tyre, nxënësit mësojnë duke kërkuar, duke analizuar dhe duke krijuar. Ata punojnë së bashku, ndajnë ide, marrin përgjegjësi dhe kuptojnë më mirë çfarë po mësojnë dhe pse kjo është e rëndësishme.

Megjithatë, edhe pse projekti konsiderohet si një strategji të nxëni e vlefshme, ndodh që ai nuk planifikohet dhe nuk zbatohet në mënyrën e duhur në procesin mësimor. Ka raste kur projektet kufizohen në disa aktivitete të rastësishme, të ndërmarra pa një lidhje të qartë me qëllimet e lëndës ose pa u integruar me lëndë të tjera dhe me kompetencat kyç (kur është e nevojshme). Ndodh, gjithashtu që mungon një plan i detajuar i fazave të projektit, që nuk ndahen mirë detyrat mes nxënësve, që nuk jepen udhëzime të qarta për nxënësit, si dhe që nuk ka një mënyrë e strukturuar dhe transparente për të vlerësuar procesin dhe rezultatet. Këto mangësi e bëjnë projektin të humbasë vlerën e tij si strategji të nxëni e dobishme dhe e kthejnë në një aktivitet sipërfaqësor, pa ndikim të dukshëm në zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Nga diskutimet me mësues dhe nga përvoja e përditshme në shkolla del se ka ende





pasiguri për mënyrën si duhet zgjedhur dhe zhvilluar një projekt. Shumë mësues ndihen të pasigurt se si të përcaktojnë temat, si t'i lidhin ato me kompetencat e lëndës dhe me kompetencat kyç, si të përshtatin kërkesat sipas nivelit të nxënësve dhe si të bëjnë një vlerësim të drejtë e motivues. Sidomos organizimi i projekteve ndërlëndore kërkon më shumë bashkëpunim mes mësuesve dhe një qasje të përbashkët, e cila jo gjithmonë është e lehtë për t'u arritur.



Për këtë arsye është hartuar ky udhëzues, që të shërbejë si një ndihmë praktike për mësuesit e gjuhës dhe të letërsisë në AMU¹ dhe në AML², por edhe për të gjithë ata që dëshirojnë të zhvillojnë projekte ndërlëndore. Udhëzuesi ofron sqarime mbi kuptimin dhe llojet e projekteve, sugjerime se si mund të zgjidhen temat, si të planifikohet dhe të drejtohet puna hap pas hapi, si dhe ide konkrete për projekte lëndore në gjuhë, letërsi apo projekte ndërlëndore. Ai paraqet edhe mënyra praktike të vlerësimit që ndihmojnë si mësuesin, ashtu edhe nxënësin, të shohin progresin gjatë gjithë procesit.

Gjithashtu, ky udhëzues ofron modele që i ndihmojnë mësuesit të planifikojnë dhe të realizojnë projekte, por gjithashtu u lë atyre hapësirë për të hartuar vetë projekte që përshtaten me nevojat dhe problematikat e klasës, shkollës dhe komunitetit. Kështu,

¹ Arsimi i mesëm i ulët

² Arsimi i mesëm i lartë





projektet bëhen një pjesë e zakonshme e procesit mësimor, duke i pasuruar përvojat e nxënësve dhe duke i angazhuar ata në mënyrë më aktive dhe më kuptimplote.

1. PËRKUFIZIMI DHE KLASIFIKIMI I PROJEKTEVE

1.1. Çfarë janë projektet?

Projektet në arsim janë strategji të nxëni në të cilat nxënësit angazhohen gjatë vitit shkollor për të hulumtuar, analizuar, krijuar ose zgjidhur një problem, çështje apo temë me interes për ta, për shkollën ose për komunitetin. Ato zakonisht përfundojnë me një produkt konkret ose një prezantim publik të punës së kryer. Projekti i vendos nxënësit në qendër të procesit, duke u dhënë atyre mundësinë të mësojnë në mënyrë aktive, të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, si dhe të marrin përgjegjësi për të nxënësit e tyre.



Në mësimdhënien bashkëkohore, projektet shihen si një mjet i fuqishëm për të lidhur teorinë me praktikën dhe për të zhvilluar tek nxënësit kompetenca që i ndihmojnë të përballen me situata të reja në jetën e përditshme dhe në të ardhmen. Ato përfshijnë faza të qarta, që nisin nga planifikimi, vijojnë me mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, realizimin e produktit dhe përfundojnë me vlerësimin dhe reflektimin mbi të gjithë procesin. Përmes projekteve, nxënësit nuk mësojnë vetëm për një përmbajtje të caktuar, por mësojnë si të mësojnë, si të organizojnë punën, si të punojnë me të tjerët dhe si të komunikojnë idetë e tyre.





Projektet mund të jenë të përqendruara brenda një lënde të vetme (projekte lëndore) ose të ndërthurin njohuri e aftësi nga fusha/lëndë të ndryshme (projekte ndërlëndore), duke i dhënë procesit mësimor më shumë thellësi dhe kuptim.

1.2. Çfarë janë projektet lëndore?


Projektet lëndore janë strategji të nxëni që zhvillohen brenda një lënde të caktuar dhe kërkojnë një proces të gjatë në kohë, ku nxënësit angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për të hulumtuar, eksperimentuar, krijuar dhe reflektuar. Ndryshe nga detyrat e zakonshme të klasës, projektet nuk mbyllen me një ushtrim apo një tekst të shkruar në pak minuta; ato zgjasin disa javë ose edhe më gjatë dhe përfshijnë faza të qarta: nga planifikimi i punës, mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe realizimi i produktit, deri te prezantimi dhe vlerësimi i tij.

Projektet lëndore ndërtohen mbi njohuritë e aftësitë e programit. Ato i lejojnë nxënësit të shkojnë përtej riprodhimit të njohurive. Përmes tyre, ata praktikojnë aftësitë për të kategorizuar informacione, për të komunikuar në forma të ndryshme (shkrim, gojë, elemente pamore), për të bashkëpunuar dhe për të menaxhuar kohën dhe burimet. Për shembull, nxënësit mund të ndërtojnë një blog letrar, të realizojnë një ekspozitë për shkollën ose për komunitetin, të zhvillojnë një fushatë ndërgjegjësimi mbi gjuhën e urrejtjes në rrjetet sociale ose të ndërtojnë një podcast ku diskutojnë tema nga letërsia dhe gjuha.

Këto projekte u japin nxënësve mundësinë të shohin kuptimin real të asaj që mësojnë, të marrin përgjegjësi për punën e tyre dhe të zhvillojnë kompetenca që nuk i fitojnë dot vetëm me orët tradicionale të mësimi.

Projektet lëndore zakonisht planifikohen dhe drejtohen nga mësuesi i lëndës, duke marrë parasysh programin mësimor, specifikat dhe nevojat e nxënësve, si dhe kohën në dispozicion. Ato mund të realizohen individualisht, në çift ose në grupe të vogla, varësisht nga qëllimi i projektit dhe natyra e temës. Projektet lëndore, përveçse i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë lëndën, rrisin motivimin e tyre, u japin hapësirë të shprehin ide dhe të marrin përgjegjësi për produktin që krijojnë.





1.3. Çfarë janë projektet ndërlëndore?

Projektet ndërlëndore janë strategji të nxëni që ndërthurin njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime nga disa lëndë njëkohësisht, duke u dhënë nxënësve mundësinë të shohin lidhjet mes fushave/ disiplinave të ndryshme të dijes dhe të kuptojnë më mirë si funksionon bota reale. Ndryshe nga projektet lëndore që përqendrohen vetëm në qëllimet dhe rezultatet e pritshme të një lënde të vetme, projektet ndërlëndore nxisin të menduarit gjithëpërfshirës dhe zbatimin e njohurive në mënyrë të integruar. Këto projekte zakonisht planifikohen dhe realizohen nga disa mësues së bashku, të cilët bashkëpunojnë për të ndërtuar një temë ose për të zgjidhur një problem që lidhet natyrshëm me disa lëndë. Nxënësit angazhohen në veprimtari që kërkojnë të përdorin gjuhën për të komunikuar, historinë për të kuptuar kontekstin, matematikën për të analizuar të dhëna, teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit për të hulumtuar dhe për të prezantuar rezultatet, artet për t'i bërë ato vizualisht tërheqëse etj.

Më poshtë janë dhënë disa shembuj projektesh ndërlëndore:

- *Trashëgimia kulturore dhe identiteti kombëtar:* Nxënësit mund të hulumtojnë gojëdhëna, mite apo legjenda të zonës së tyre (gjuhë dhe letërsi); të mbledhin dhe të analizojnë të dhëna mbi numrin e vizitorëve apo mbi ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore (matematikë); të krijojnë një hartë digjitale ose një video prezantuese për vendet historike të komunitetit (histori dhe TIK), dhe të vizatojnë simbole karakteristike ose të realizojnë punime artistike të frymëzuara nga këto rrëfime dhe vende (art pamor).
- *Ndryshimet klimatike dhe krizat mjedisore:* Nxënësit mund të hulumtojnë mbi pasojat e ndotjes (shkencë); të matin sasinë e mbeturinave në lagje ose në fshat dhe të analizojnë të dhëna (matematikë); të hartojnë tekste sensibilizuese, slogane ose





fushata në rrjete sociale (gjuhë shqipe ose gjuhë e huaj), dhe të krijojnë postera ose video me mesazhe për mbrojtjen e natyrës (art dhe teknologji).

- *Shëndeti mendor dhe mirëqenia emocionale:* Nxënësit mund të intervistojnë bashkëmoshatarë apo specialistë (gjuhë, qytetari, psikologji), të lexojnë dhe të analizojnë tekste letrare që trajtojnë ndjenja si ankthi, vetmia ose miqësia (letërsi), dhe të përgatisin një broshurë ose podcast për të ndarë këshilla për jetesë të shëndetshme.
- *Diversiteti kulturor dhe bashkëjetesa:* Nxënësit mund të dokumentojnë ngjarje nga komunitete të ndryshme (gjuhë, histori), të analizojnë statistika mbi migracionin (matematikë), të krahasojnë zakone e veshje (art, edukatë qytetare) dhe të organizojnë një veprimtari kulturore në shkollë.
- *Inteligjenca artificiale dhe etika:* Nxënësit mund të diskutojnë në klasë rreziqet dhe përfitimet e teknologjisë (TIK dhe qytetari), të shkruajnë ese ose një lloj tjetër shkrimi mbi ndikimin e saj në jetën e tyre (gjuhë dhe letërsi), dhe të ndërtojnë modele të thjeshta në aplikacione online (teknologji).

1.4.Llojet e projekteve (kërkimore, krijuese, praktike, prezantuese etj.)

Projektet mund të marrin forma të ndryshme, në varësi të qëllimeve që synohen, të temës së zgjedhur dhe të mënyrës së organizimit. Llojet më të zakonshme të projekteve që përdoren në shkolla janë:

- *Projekte kërkimore*, ku nxënësit angazhohen të mbledhin, të përpunojnë dhe të analizojnë informacione të ndryshme mbi një temë të caktuar. Ato i ndihmojnë nxënësit të ushtrojnë mendimin kritik dhe të mësojnë si të organizojnë të dhënat dhe informacionet, p.sh., kur studiojnë ndikimin e ndotjes në një lumë ose në një liqen të zonës apo kur krahasojnë përdorimin e gjuhës në media të ndryshme.
- *Projekte krijuese*, të cilat u japin nxënësve mundësinë të shprehin idetë e tyre në mënyrë origjinale. Këto mund të jenë shkrimi i tregimeve ose i poezive, realizimi i një podcast-i apo i një shfaqje teatrale që lidh një tekst letrar me aktualitetin.
- *Projekte praktike*, të cilat kanë në qendër zbatimin konkret të njohurive dhe të aftësive. Për shembull, ndërtimi i një fjalori tematik për të folmet lokale, përgatitja e një ekspozite gjuhësore ose ndërtimi i një aplikacioni të thjeshtë për të prezantuar proverba apo shprehje frazeologjike shqiptare.






- *Projekte prezantuese*, në të cilat fokusi vendoset tek përgatitja dhe prezantimi publik i punës së bërë. Këto mund të jenë prezantime multimediale, diskutime të moderuara nga nxënësit ose organizimi i një “Dite të hapur” ku ftohen prindërit dhe komuniteti për të parë produktet e projektit.

Shpesh, një projekt i vetëm mund të kombinojë disa prej këtyre tipareve ose të gjitha. Për shembull, një projekt mund të fillojë me kërkime, të kalojë në fazën krijuese dhe të përfundojë me një prezantim publik, duke u dhënë nxënësve një përvojë të plotë, ku ata mësojnë të gërshetojnë aftësi të ndryshme në një proces të vetëm. Në kushtet e shkollave tona, duke qenë se projektet kanë peshë të rëndësishme në vlerësimin e nxënësve dhe shtrihen gjatë gjithë vitit shkollor, rekomandohen projekte që i ndërthurin këto tipare.

2. QËLLIMET E PROJEKTEVE

Projektet nuk janë thjesht një strategji alternative të nxëni, por një mënyrë për të arritur qëllime të rëndësishme që lidhen me formimin e përgjithshëm të nxënësve. Ato synojnë të shkojnë përtej të nxënit të njohurive dhe t’i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë një sërë kompetencash/ aftësish të dobishme për jetën, shoqërinë dhe tregun e punës.





Qëllimet kryesore të projekteve janë:

- Të thellojnë dhe të zgjerojnë njohuritë e nxënësve në tema që lidhen me kurrikulën, duke i vendosur ato në kontekste konkrete të jetës reale.
- Të zhvillojnë të menduarit kritik dhe krijues, duke i shtyrë nxënësit të analizojnë, të krahasojnë, të gjykojnë dhe të gjejnë zgjidhje të reja për probleme të ndryshme të shkollës dhe/ose të komunitetit.
- Të nxisin punën në grup dhe bashkëpunimin, duke u dhënë nxënësve mundësinë të ndajnë detyra, të diskutojnë ide dhe të arrijnë së bashku një produkt të përbashkët.
- Të zhvillojnë aftësitë komunikuese, me shkrim dhe me gojë, si dhe përdorimin e gjuhës në forma të ndryshme (*tekste, prezantime, media digjitale*).
- Të edukojnë nxënësit me qëndrime të përgjegjshme dhe qytetare, si respekti për punën e të tjerëve, respektimi i afateve dhe kujdesi për cilësinë e asaj që prezantojnë.
- Të mësojnë si të nxënë, duke i ndihmuar nxënësit të kërkojnë, të organizojnë dhe të përpunojnë informacion, si dhe të menaxhojnë kohën e burimet gjatë procesit të projektit.

Në këtë mënyrë, projektet janë një mjet i fuqishëm për ta bërë të nxënit më tërheqës, më të kuptueshëm dhe më të lidhur me jetën e përditshme të nxënësve, duke ndërtuar baza të forta për të ardhmen e tyre personale, profesionale dhe shoqërore.

3.PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PROJEKTEVE

3.1.Si përzgjidhen temat e projekteve?

Përzgjedhja e temës së projektit është një nga hapat më të rëndësishëm në procesin e planifikimit. Një temë e menduar mirë jo vetëm që garanton përmbushjen e rezultateve të të nxënit, por rrit edhe kuriozitetin dhe motivimin e nxënësve. Kjo fazë mund të zhvillohet në disa mënyra:

- *Tema e sugjeruar nga nxënësit:* Shumë mësues i përfshijnë nxënësit që në fillim të vitit shkollor, duke organizuar diskutime ose stuhi mendimi (brainstorming). Nxënësit shprehin idetë, shqetësimet ose temat që i interesojnë. Nga këto mund të përzgjidhen ato që kanë më shumë potencial edukativ dhe që lidhen me





kompetencat e lëndës dhe me kompetencat kyç. Ky proces rrit ndjeshëm ndjenjën e pronësisë së nxënësve mbi projektin dhe e bën atë më tërheqës për ta.

- *Tema e përcaktuar nga mësuesi:* Në shumë raste, sidomos kur projekti ka një funksion të qartë për të përforcuar kompetenca ose tematika të caktuara të programit lëndor, mësuesi propozon temën. Kjo siguron që projekti të lidhet ngushtë me qëllimet e lëndës dhe të jetë i arritshëm për të gjithë nxënësit. Për shembull, në gjuhë, mund të zgjidhet tema “Gjuha e teksteve argumentuese në mediat online”.
- *Tema e përcaktuara në bashkëpunim:* Një qasje tjetër është kur mësuesi sjell disa ide fillestare të bazuara në programin lëndor, ndërsa nxënësit ndihmojnë për t’i konkretizuar, zgjeruar ose zgjedhur. Kjo mënyrë bashkëpunuese arrin të ruajë ekuilibrin mes qëllimeve mësimore dhe interesave të nxënësve.
- *Disa shkolla përdorin edhe diskutime të vogla mes “klasash”, debate apo anketime të shkurtra, ku votohet për temën që i duket më interesante shumicës. Edhe kjo ndihmon që nxënësit të ndihen pjesë e vendimmarrjes dhe të kenë më shumë përkushtim gjatë zbatimit të projektit.*

Pavarësisht procedurës së përzgjedhjes, është e rëndësishme që mësuesi të kontrollojë që tema të jetë:

- e lidhur me kurrikulën dhe me kompetencat e saj.
- e përshtatshme për moshën dhe për nivelin e klasës.
- e realizueshme për kohën dhe me burimet në dispozicion.
- e mjaftueshme për të nxitur kërkim, krijimtari e bashkëpunim.

Temat e projekteve mund të ndahen sipas fokusit të tyre dhe sipas burimit të frymëzimit. Disa prej llojeve më të zakonshme janë:

- *Tema që rrjedhin nga programi mësimor:* Këto janë tema që përforcojnë drejtpërdrejt njohuritë dhe aftësitë e parashikuara lëndore në programin mësimor. P.sh., në gjuhën shqipe: “Si ndërtohet argumentimi në debate televizive”, ose në letërsi: “Portretizimi i figurës së femrës në letërsinë bashkëkohore”.
- *Tema që ndërlidhin kompetencat kyç, temat ndërkurrikulare dhe tematika që trajtohen në testime ndërkombëtare si PISA:* Këto tema ndërlidhin aspekte të veçanta:
 - a) **të kompetencave kyç të kurrikulës** (rezultatet e të nxënit të tyre janë në programet lëndore të të gjitha klasave):





- ✓ Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare
- ✓ Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
- ✓ Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri
- ✓ Kompetenca digjitale
- ✓ Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënës
- ✓ Kompetenca qytetare
- ✓ Kompetenca e sipërmarrjes
- ✓ Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore

b) të temave ndërkurrikulare:

- ✓ Identiteti kombëtar
- ✓ Qytetaria aktive dhe sipërmarrja
- ✓ Shëndeti mendor, fizik dhe siguria
- ✓ Zhvillimi i qëndrueshëm
- ✓ Teknologjia, shoqëria dhe media

c) të temave që trajtohen në tekste që përdor PISA për të vlerësuar aftësitë e të lexuarit:

- ✓ Jeta personale, si p.sh.: marrëdhënie familjare, marrëdhënie shoqërore, përvoja personale, vendime të jetës së përditshme.
- ✓ Jeta publike dhe qytetare, si p.sh.: çështje sociale, njoftime publike, të drejtat dhe përgjegjësitë qytetare.
- ✓ Jeta shkollore dhe arsimore, si p.sh.: rregulla shkollore (rregullore), informacione për projekte, njoftime brenda shkollës.
- ✓ Shkenca dhe mjedisi, si p.sh.: natyra, teknologjia, shëndeti, ndryshimet klimatike.
- ✓ Kultura dhe media, si p.sh.: tekste nga media, opinione, kritika kulturore, komente të lexuesve etj.
- *Tema të lidhura me çështje aktuale:* Këto tema i ndihmojnë nxënësit të lidhin dijet me botën reale, si për shembull, të zhvillojnë një projekt mbi ndikimin e rrjeteve sociale në mënyrën si flasim dhe shkruajmë ose mbi rëndësinë e përdorimit të gjuhës së respektueshme dhe brenda rregullave të etikës në internet.
- *Tema që vijnë nga konteksti lokal:* Këto tema afrojnë nxënësit me historinë, traditat, problematikat dhe sfidat e komunitetit të tyre. Për shembull, nxënësit mund të





hulumtojnë mbi të folmet në fshatra të ndryshme të zonës, të mbledhin fjalë dialektore ose të bëjnë një botim mbi legjendat dhe përrallat në fshatin ose në qytetin e tyre.

- *Tema të bazuara në interesat dhe pasionet e nxënësve:* Këto mund të jenë tema të propozuara nga vetë nxënësit. Ato lidhen me muzikën, sportin, teknologjinë, kulturën ose problemet që ata ndiejnë më afër. Për shembull: “Si ndikojnë videot virale tek fjalori i të rinjve?” ose “Të analizojmë tekstet e këngëve që dëgjojmë më shumë”.
- *Tema që ndërthurin dimensionet e mësipërme,* duke bërë që projekti të jetë njëkohësisht i dobishëm për të arritur kompetencat e lëndës, i lidhur me shoqërinë, me komunitetin dhe me interesat personale të nxënësve.

Në këtë mënyrë, përzgjedhja e temës nuk është thjesht një hap teknik, por është një mundësi për të motivuar nxënësit, për t’i bërë të ndihen të përfshirë dhe për të garantuar që projekti të jetë i suksesshëm.

Çfarë duhet të ketë parasysh mësuesi kur zgjidhet tema e projektit?

- A lidhet kjo temë drejtpërdrejt me qëllimet dhe me kompetencat e lëndës ose të fushës?
- A është kuptimplote dhe me interes për nxënësit? A pasqyron çështje që ata i shohin të rëndësishme për veten, për shkollën apo për komunitetin?
- A është i realizueshëm brenda kohës dhe me burimet që ka shkolla në dispozicion?
- A u jep mundësi nxënësve të bashkëpunojnë, të krijojnë dhe të marrin përgjegjësi?
- A parashikon në fund një produkt të qartë (*material ose digjital*) që mund të prezantohet?

3.2.Si përshtaten projektet me moshën dhe me nivelin e nxënësve?

Përshtatja e projekteve me moshën dhe me nivelin e nxënësve është një ndër aspektet më të rëndësishme që duhet të marrë parasysh mësuesi kur planifikon dhe organizon punën. Një projekt i përshtatshëm ndihmon që nxënësit të angazhohen realisht, të ndihen të aftë për ta çuar përpara dhe të përfitojnë në mënyrë të dukshme nga procesi. Disa udhëzime të përgjithshme për këtë janë:





- *Sipas moshës dhe stadi zhvillimor:* Në arsimin fillor, projektet duhet të jenë më të thjeshta, me detyra të vogla e të qarta, me shumë elemente konkrete dhe me punë të dukshme (vizatime, krijime me dorë, prezantime të thjeshta). Në arsimin e mesëm të ulët, projektet mund të përfshijnë më shumë kërkime, përpunim informacioni dhe paraqitje të strukturuar, duke i mësuar nxënësit të bashkëpunojnë dhe të ndajnë përgjegjësi në grup.

Në arsimin e mesëm të lartë, projektet mund të jenë më komplekse, të kërkojnë analiza, krahasime, shkrime më të gjata dhe përdorim të burimeve të ndryshme (librave, internetit, statistikave), si dhe të përfundojnë me prezantime multimediale.

- *Sipas nivelit të njohurive dhe të kompetencave të nxënësve:* Mësuesi duhet të sigurohet që projekti është në një nivel të përshtatshëm për klasën, as shumë i lehtë që të mos ketë kuptim, as shumë i vështirë sa t'i demotivojë nxënësit. Për këtë mund të bëhen teste të shkurtra diagnostikuese, biseda paraprake ose të bazohet tek përvoja e mësuesve me klasën.
- *Në përshtatje me nivelet dhe me aftësitë:* Edhe brenda të njëjtit projekt, mësuesi mund të diferencojë sipas nevojave të nxënësve, si p.sh., disa grupe mund të punojnë me detyra më të thjeshta, disa me detyra më të avancuara; disa mund të paraqesin me poster, të tjerë me prezantim digjital. Kjo i bën të gjithë nxënësit të ndihen të përfshirë, pavarësisht niveleve dhe aftësive të tyre.

Në këtë mënyrë, projekti kthehet në një mjet që i nxit të gjithë nxënësit të marrin pjesë sipas mundësive të tyre, duke përparuar dhe duke ndërtuar besim tek vetja.

3.3.Hapat e zhvillimit të projekteve

Zhvillimi i një projekti kalon zakonisht në disa faza të dallueshme, të cilat ndihmojnë që puna të jetë e organizuar, e kuptueshme për nxënësit dhe të çojë në një produkt final me vlerë. Këto hapa nuk janë gjithmonë të ngurtë; ndonjëherë mund të ndërthuren ose të përsëriten sipas nevojës, por parimisht ndjekin një rrjedhë të caktuar që fillon me planifikimin dhe mbyllet me prezantimin dhe me reflektimin.





Kjo strukturë i ndihmon nxënësit të ndjekin procesin hap pas hapi, të mësojnë si të organizojnë kohën dhe punën e tyre, si të ndajnë detyrat, si të kapërcejnë vështirësitë gjatë rrugës dhe si të ndihen krenarë për arritjen e objektivit final.



a) **Planifikimi**

Planifikimi është hapi i parë dhe një nga më të rëndësishmit në zhvillimin e një projekti. Në këtë fazë, mësuesi së bashku me nxënësit përcaktojnë qartë temën, qëllimet dhe produktin final që pritet të realizohet. Vendosen gjithashtu afatet kohore, ndahen detyrat kryesore dhe grupet e punës, si dhe diskutohet mënyra si do të monitorohet procesi.

Disa elemente kyç të planifikimit janë:

- Përcaktimi i temës së projektit, duke u siguruar që lidhet me kompetencat dhe me rezultatet e programit mësimor, por edhe që është interesante e motivuese për nxënësit.
- Vendosja e produkteve që do të krijohen, si p.sh. posterë, video, fletëpalosje, intervista të përmbledhura, revistë online, prezantim i strukturuar etj.
- Përgatitja e një plani kohor, ku ndahen fazat dhe përcaktohen datat orientuese për secilën pjesë të punës (p.sh., kërkimi i informacionit, përpunimi i të dhënave dhe i informacionit, përgatitja e prezantimit, prezantimi, reflektimi).
- Organizimi i nxënësve në grupe ose në çifte (kur projekti është bashkëpunues), duke ndarë role të qarta për secilin anëtar të grupit.
- Diskutimi i mënyrave të mbledhjes së materialeve dhe të burimeve, si librat, interneti, intervistat me njerëz të komunitetit ose të afërm, vëzhgimet në terren etj.
- Vendosja e disa rregullave të përbashkëta që ndihmojnë në respektimin e punës së të gjithëve dhe e bëjnë procesin më të qetë (p.sh., si të ndajnë kohën gjatë diskutimeve ose si të japin sugjerime të dobishme për njëri-tjetrin).





Planifikimi i mirë i jep projektit një bosht të qartë dhe i ndihmon nxënësit të mos ndihen të hutuar apo të lënë në dorë të rastësisë gjatë punës. Ai krijon një ndjenjë sigurie dhe i motivon që ta çojnë projektin deri në fund me sukses.

b) Zbatimi

Zbatimi është faza ku projekti merr jetë. Në këtë hap, nxënësit nisin të kryejnë konkretisht të gjitha veprimtaritë e parashikuara në plan, duke zbatuar idetë dhe ndarjen e roleve që kanë bërë më parë.

Në këtë fazë, nxënësit:

- kërkojnë dhe mbledhin informacion, nëpërmjet leximit të burimeve të ndryshme, kërkimeve online, intervistave, anketave, vëzhgimeve të drejtpërdrejta etj.
- organizojnë dhe përpunojnë të dhënat, duke zgjedhur çfarë është më e rëndësishme dhe duke ndërtuar skema, tabela ose shënime që i ndihmojnë të strukturojnë materialin e mbledhur.
- krijojnë produktin e projektit që mund të jetë një tekst i shkruar (si raport, libër, revistë ose gazetë e klasës), një video, një podcast, një aplikacion, një poster, një ekspozitë apo një paraqitje multimediale.
- bashkëpunojnë aktivisht, diskutojnë idetë, ndihmojnë njëri-tjetrin dhe gjejnë zgjidhje për problemet që dalin gjatë rrugës.
- mbajnë shënime për procesin, për të pasur më vonë materiale që i ndihmojnë në reflektim dhe vlerësim.

Roli i mësuesit në këtë fazë është të udhëheqë, këshillojë dhe motivojë, duke monitoruar nëse po respektohet plani kohor dhe cilësia e punës. Ai nuk duhet të bëjë punën në vend të nxënësve, por të sigurohet që çdo grup ose çdo nxënës të kuptojë qartë çfarë duhet të bëjë dhe të marrë përgjegjësi për pjesën dhe punën e vet.

Zbatimi është edhe pjesa ku nxënësit hasin më shumë sfida praktike (si të gjejnë informacion të besueshëm, si të ndajnë detyrat në grup, si të përshtaten në grup ose si të organizojnë idetë) ndaj mbështetja e vazhdueshme dhe nxitja e iniciativës janë shumë të rëndësishme.





c) Monitorimi

Monitorimi është një proces që shoqëron zbatimin e projektit dhe ndihmon mësuesin për të siguruar që gjithçka po ecën sipas planit dhe cilësisë së pritur. Ai nuk është një hap i veçuar në fund, por një mbështetje e vazhdueshme gjatë gjithë punës së nxënësve.

Në këtë fazë, mësuesi:

- vëzhgon punën e nxënësve, qoftë në grup, qoftë individualisht, duke kaluar midis tavolinave ose duke ndjekur raportimet e grupeve për ecurinë e tyre.
- bën pyetje udhëzuese që i ndihmojnë nxënësit të mendojnë më qartë për problemet, të analizojnë atë që kanë mbledhur dhe të marrin vendime të argumentuara për hapat e mëtejshëm.
- jep komente dhe sugjerime konkrete, duke theksuar pikat e forta të punës dhe duke ofruar ide për të përmirësuar pjesët ku ka pasiguri ose dobësi.
- ndihmon në menaxhimin e kohës, për të shmangur vonesat apo përqendrimin e tepërt vetëm në një pjesë të projektit.
- siguron që secili nxënës të jetë i përfshirë, sidomos kur puna bëhet në grupe, duke ndihmuar për të balancuar kontributin dhe përgjegjësitë.

Monitorimi është gjithashtu një mundësi shumë e mirë për të ndjekur zhvillimin individual të kompetencave, të cilat shpesh nuk mund të vërehen vetëm nga produkti final. Ai e kthen projektin në një proces të nxëni ku mësohet jo vetëm çfarë të bëhet, por edhe si të punohet dhe si të bashkëpunohet.

d) Përmbyllja dhe prezantimi

Përmbyllja dhe prezantimi janë fazat ku nxënësit finalizojnë punën e tyre dhe e ndajnë me të tjerët, duke treguar jo vetëm produktin që kanë krijuar, por edhe përpjekjet dhe çfarë kanë mësuar gjatë procesit.

Në këtë fazë:

- Nxënësit sistemojnë materialet, bëjnë rregullimet e fundit në produktin përfundimtar (poster, video, aplikacion, botim, broshurë, fjalime ose dramatizime) dhe përgatiten për ta paraqitur në një mënyrë sa më të qartë dhe tërheqëse.





- Nxënësit parapërgatiten për prezantimin, ndajnë pjesët që do të flasë secili, diskutojnë si do t'u përgjigjen pyetjeve dhe si do të shpjegojnë zgjedhjet e bëra gjatë projektit.
- Nxënësit prezantojnë punën e tyre para publikut që mund të jenë bashkëmoshatarët, mësues të tjerë, prindër, anëtarë të komunitetit etj. Prezantimi jo vetëm u rrit vetëbesimin, por i ndihmon të ushtrojnë aftësinë për të folur në publik, për të komunikuar mendimet, për të argumentuar dhe për të bashkëbiseduar.
- Më pas zhvillohet një reflektim mbi të gjithë procesin, ku nxënësit (dhe mësuesi) diskutojnë çfarë mësuan, cilat ishin vështirësitë dhe si mund ta përmirësojnë projektin herën tjetër. Ky reflektim mund të bëhet në formë diskutimi të hapur, me fletë reflektimi ose me një teknikë "*Rrethi i reflektimit*", e cila është një teknikë e thjeshtë reflektimi në fund të projektit, ku çdo nxënës (ose grup) merr radhën të thotë shkurt një mendim, përgjigje ose ndjesi, pa u ndërprerë. Zakonisht përdoren pyetje të tipit:
 - ✓ Çfarë mësova?
 - ✓ Çfarë më pëlqeu më shumë?
 - ✓ Çfarë do të ndryshoja?

Në këtë mënyrë, përmbyllja dhe prezantimi nuk shihen thjesht si një formalitet për të treguar produktin, por si një pjesë kryesore e të nxënës, ku nxënësit përfitojnë nga komentet, sugjerimet dhe vlerësimet e të tjerëve, ndërgjegjësohen për arritjet e tyre dhe mësojnë të vlerësojnë punën e tyre dhe të grupit.

Struktura e prezantimit të projektit

Një strukturë sugjeruese për prezantimin e projektit është:

Hyrja

- Prezantimi i temës së projektit dhe i qëllimeve të tij.
- Prezantimi i grupit të punës që ka punuar me projektin.

Zhvillimi

- Përshkrimi i shkurtër i rëndësisë së temës së projektit për nxënësit dhe/ose shkollën dhe/ ose komunitetin.





- Prezantimi i përfituesve të projektit.
- Prezantimi i metodologjisë së përdorur për të përmbushur qëllimet (p.sh., metodat dhe mjetet e hulumtimit, instrumentet, mbledhja dhe analiza e të dhënave etj.).
- Shpjegimi i hollësishëm i veprimtarive kryesore të projektit.
- Përshkrimi i produktit të projektit.

Mbyllja

- Falënderimi për vëmendjen.
- Sqarime dhe përgjigje kundrejt pyetjeve të mësuesit dhe të klasës.
- Vlerësimi i mësuesit, vetëvlerësim ose vlerësim i nxënësve për njëri-tjetrin.

Është e rëndësishme që prezantimi të jetë i strukturuar mirë dhe të ketë një rrjedhë logjike që e bën të lehtë për dëgjuesit për të ndjekur dhe për të kuptuar përmbajtjen e projektit. Përveç kësaj, prezantuesi duhet të përdorë një gjuhë të qartë dhe të përshtatshme për dëgjuesit për të siguruar që mesazhi të jetë i kuptueshëm dhe i përshtatshëm. Prezantimi i projektit mund të zgjasë afërsisht 5 minuta. Më pas nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve të të tjerëve rreth projektit të tyre.

4.ROLI I MËSUESIT DHE I NXËNËSVE NË ÇDO FAZË TË PROJEKTEVE

Gjatë projektit nxënësi vendoset në qendër të procesit, ndërsa mësuesi kalon nga roli i transmetuesit të njohurive në një udhëheqës dhe lehtësues i të nxënit. Megjithatë, secila fazë e zhvillimit të projektit ka specifikat e veta dhe kërkon role të ndryshme si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit. Përshkrimi i këtyre roleve është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Faza e projektit	Mësuesi	Nxënësit
Planifikimi	Mësuesi ndihmon në përzgjedhjen e temës, përcakton qëllimin dhe kompetencat që do të zhvillohen, diskuton për	Nxënësit japin ide, propozojnë tema ose forma të produktit, marrin pjesë në ndarjen e roleve dhe planifikojnë kohën e tyre.





	produktin përfundimtar, ndihmon në ndarjen e detyrave dhe të afateve, si dhe ofron udhëzime të qarta për burimet që mund të përdoren.	
Zbatimi dhe monitorimi	Mësuesi ndjek punën e nxënësve, bën pyetje nxitëse, udhëzon, jep sugjerime, ndihmon në tejkalimin e pengesave dhe kujdeset që grupet të punojnë në mënyrë të ekuilibruar. Gjithashtu, siguron që të respektohen afatet kohore dhe cilësia e punës.	Nxënësit hulumtojnë, mbledhin dhe përpunojnë informacionin, hartojnë një draft të produktit, krijojnë produktin (tekst, video, poster, aplikacion, dramatizim etj.), ndihmojnë njëri-tjetrin, ndajnë përgjegjësi dhe kërkojnë ndihmë kur kanë nevojë.
Përmbyllja dhe prezantimi	Mësuesi përcakton hapësirën dhe datën/at e prezantimit, i ndihmon nxënësit të strukturojnë shpjegimin dhe prezantimin e tyre, i udhëzon për komunikim të qartë, i nxit të dëgjojnë e të komentojnë me respekt punën e të tjerëve, vlerëson projektet e nxënësve, i nxit ata të reflektojnë për përvojën e tyre.	Nxënësit prezantojnë punën e bërë, tregojnë procesin, u përgjigjen pyetjeve dhe marrin vlerësim dhe komente nga bashkëmoshatarët dhe mësuesi.





5. SHEMBUJ TEMASH PËR PROJEKTE

5.1. Projekte lëndore

- *Shqipja ime në rrjetet sociale*: Nxënësit krijojnë një seri videosh të shkurtra për rrjete sociale, ku shpjegojnë në mënyrë të thjeshtë dhe tërheqëse disa rregulla gramatikore e drejtshkrimore, prezantojnë fjalë, shprehje frazeologjike dhe fjalë të urta të bukura dhe të rralla të shqipes ose sfidojnë ndjekësit me lojëra fjalësh.
- *Dialektet shqiptare: një pasuri që s'duhet humbur*: Nxënësit ndërmarrin një projekt ku mbledhin fjalë, shprehje dhe krijime (legjenda, përralla etj.) karakteristike nga dialektet e ndryshme të shqipes, i intervistojnë të moshuarit e zonës ose njerëz të ardhur nga krahina të tjera, dhe i përpunojnë këto materiale në formën e një dokumentari të shkurtër ose podcast-i që pasqyron larminë dhe bukurinë e dialekteve të gjuhës sonë.
- *Përdorimi i gjuhës shqipe në komentet dhe postimet online*: Nxënësit analizojnë materiale nga rrjetet sociale për të parë se si përdoret shqipja në këtë hapësirë digjitale, si shfaqet ose si mungon respekti në mënyrën e komunikimit, si dhe çfarë ndikimi ka kjo formë e të shkruarit online në gjuhën dhe në kulturën tonë të komunikimit sot. Në fund, ata përgatisin një prezantim ose një seri posterash digjitalë me gjetjet dhe mesazhet kryesore për të promovuar komunikimin e përgjegjshëm në internet. Për këtë projekt, nxënësit mund të përdorin komente dhe postime publike në faqe shqiptare lajmesh, portale argëtimi, faqe artistësh ose të figurave publike, grupe të hapura në Facebook etj. Ata nuk do të analizojnë mesazhe private, profile personale të mbrojtura ose biseda të mbyllura, duke respektuar plotësisht privatësinë e individëve dhe duke u përqendruar vetëm tek përmbajtja e publikuar hapur për të gjithë.
- *Gjuha shqipe në meme*: Nxënësit krijojnë një faqe ose një galeri me meme humoristike që përçojnë mesazhe për rëndësinë e drejtshkrimit të saktë, kuptimin e fjalëve të rralla të shqipes dhe pasurinë e saj leksikore, duke e bërë gjuhën tonë më të afërt dhe më të dashur për fëmijët dhe të rinjtë.
- *Fjalët që po humbasim*: Nxënësit realizojnë një projekt kërkimor ku mbledhin dhe dokumentojnë fjalë të vjetra ose të rralla të shqipes që sot përdoren gjithnjë e më





pak, duke biseduar me të moshuar, kërkuar në libra apo tekste të vjetra dhe duke ndërtuar një mini-fjalor online të ilustruar me kuptime, shembuj përdorimi dhe, sipas mundësisë, edhe me fragmente letrare ku këto fjalë janë përdorur.

- *Letërsia dhe ne*: Nxënësit organizojnë një klub të vogël leximi ku zgjedhin së bashku tregime ose poezi bashkëkohore shqiptare, i lexojnë e diskutojnë në grup, pastaj shkruajnë reflektime, komente personale ose krijojnë ilustrime që pasqyrojnë mënyrën si e kanë përjetuar tekstin, duke e bërë letërsinë më të afërt me botën e tyre.
- *Kujtimet e fëmijërisë*: Nxënësit shkruajnë ose mbledhin rrëfime të shkurtra autobiografike të vetat dhe/ose të familjarëve të tyre për ngjarje të paharruara të fëmijërisë, të cilat më pas i organizojnë në një përmbledhje të ilustruar me vizatime apo fotografi, duke krijuar një mozaik të vogël të jetës së tyre dhe të brezave para tyre.
- *Gjurmë të gjuhës së urrejtjes*: Nxënësit analizojnë komente online, tituj lajmesh dhe postime që përdorin gjuhë fyese, përjashtuese ose diskriminuese, për të mësuar si të dallojnë shenjat e gjuhës së urrejtjes dhe si ta shmangin atë në komunikimin e tyre të përditshëm, duke hartuar më pas edhe disa rregulla ose sugjerime praktike për të shkruar me respekt në rrjet.

5.2. Projekte ndërlëndore

Projektet që paraqiten më poshtë janë shembuj që ndërthurin njohuri dhe aftësi nga lëndë të ndryshme, duke përfshirë gjithmonë në mënyrë të dukshme gjuhën shqipe dhe letërsinë. Këto projekte mund të lidhen me temat ndërkurrikulare të rëndësishme për shoqërinë e sotme, si zhvillimi i qëndrueshëm, të drejtat e njeriut, identiteti kombëtar, barazia, mirëqenia dhe shëndeti, media etj., duke i ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë botën dhe të marrin pjesë aktivisht në të.

- *Zëri i natyrës*: Nxënësit mbledhin të dhëna për ndotjen në zonën ku jetojnë (biologji, kimi dhe matematikë) dhe më pas, të ndikuar prej tyre, shkruajnë ese, poezi dhe artikuj sensibilizues për mbrojtjen e mjedisit (gjuhë shqipe dhe letërsi). Këto krijime i përfshijnë në një revistë digjitale ose i prezantojnë publikisht gjatë një takimi me komunitetin ose në median lokale. Përveç kësaj, realizojnë postera





artistikë me vargje të zgjedhura nga tekstet e tyre, duke bashkuar artin pamor me mesazhin e gjuhës (arte dhe teknologji).

- *Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë:* Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë tekste letrare e tekste joletrare që trajtojnë aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut (gjuhë dhe letërsi), analizojnë raste të padrejtësive dhe të diskriminimit në shoqëri dhe më pas shkruajnë artikuj, opinione ose poezi që përcjellin mesazhe për barazi dhe respekt. Këto i kthejnë në postera, meme ose video sensibilizuese (art dhe teknologji), të cilat i prezantojnë para klasave të tjera për të nxitur diskutime dhe debate që kanë si qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve.
- *Fjalët, rrëfimet dhe simbolet tona:* Nxënësit mbledhin gojëdhëna, mite dhe frazeologji të rralla nga zona e tyre (gjuhë dhe letërsi), hulumtojnë për kuptimet historike e kulturore të tyre (histori), dhe i përpunojnë këto materiale duke krijuar një album ilustrimesh ose një video prezantuese (art dhe teknologji). Projekti përmbyllet me një veprimtari në shkollë ku nxënësit recitojnë pjesë të zgjedhura nga tregimet dhe shpjegojnë simbolet e përdorura.
- *Fjalët që na bëjnë mirë:* Nxënësit realizojnë një anketë mbi ndjenjat e lumturisë dhe stresin tek vetja dhe shokët e tyre (*matematikë, psikologji dhe qytetari*), lexojnë poezi e fragmente letrare që flasin për gëzimin dhe mirëqenien emocionale (*gjuhë dhe letërsi*), dhe më pas krijojnë tekste të shkurtra motivuese ose aforizma të tyre. Këto i shndërrojnë në një “mur të fjalëve të mira” brenda shkollës dhe organizojnë një diskutim të hapur për të ndarë mesazhet që i bëjnë të ndihen më mirë.
- *Fjala jonë në internet:* Nxënësit diskutojnë çështje të etikës digjitale dhe të drejtës për privatësi (qytetari), analizojnë komente dhe tituj online për të dalluar gjuhën fyese ose përjashtuese (gjuhë shqipe), dhe shkruajnë udhëzime të shkurtra për mënyrën si të komunikojnë me respekt në rrjet. Më pas, këto mesazhe i kthejnë në postera apo video sensibilizuese që i shpërndajnë në faqet e shkollës në mediat sociale (art dhe teknologji).






6. VLERËSIMI I PROJEKTEVE

Vlerësimi i projekteve është i domosdoshëm për ta kthyer këtë mënyrë pune në një pjesë kuptimplote të procesit mësimor. Ai ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë arritjet e tyre, të reflektojnë mbi të nxënit, të shohin pikat e forta dhe ato që kanë nevojë për përmirësim. Për mësuesin, vlerësimi i projekteve shërben për të ndjekur zhvillimin e kompetencave të nxënësve, jo vetëm në nivel të njohurive, por edhe të aftësive si: komunikimi, bashkëpunimi, kreativiteti, mendimi kritik, sipërmarrja dhe menaxhimi.

Në këtë pjesë do të trajtohen tri aspekte kryesore:

- Si përcaktohen kriteret e vlerësimit?
- Pse është e rëndësishme të vlerësohet jo vetëm produkti final, por edhe i gjithë procesi i punës gjatë projektit?
- Si mund të përdoren modele të thjeshta rubrikash ose tabelash për ta bërë këtë vlerësim të qartë dhe të drejtë për nxënësit?



6.1. Rëndësia e vlerësimit të procesit

Projektet janë gjithmonë të natyrës impenjative për nxënësit, pasi kërkojnë kohë, përpjekje të vazhdueshme dhe angazhim të shumanshëm gjatë gjithë vitit shkollor. Përveç rezultateve të dukshme në fund, procesi që ndjekin nxënësit për të arritur deri





tek produkti përfundimtar ka një vlerë të madhe edukative. Pikërisht gjatë këtij procesi ata mësojnë të planifikojnë, të hulumtojnë, të analizojnë informacione, të diskutojnë dhe të ndajnë ide, të bashkëpunojnë, të marrin vendime dhe të zgjidhin probleme.



Për këtë arsye, vlerësimi i projekteve nuk duhet të kufizohet vetëm tek produkti final, sado i plotë apo i strukturuar të jetë ai, por duhet të marrë në konsideratë me kujdes edhe të gjitha fazat e punës që e kanë paraprirë. Në këtë mënyrë nxënësit kuptojnë se rëndësi ka jo vetëm çfarë arrijnë të prodhojnë në fund, por edhe si punojnë përgjatë gjithë procesit: sa seriozisht i qasen detyrës, sa të përgjegjshëm janë në ndarjen e roleve, si kapërcejnë sfidat dhe si zhvillojnë aftësitë e tyre gjatë rrugës.

Një vlerësim i tillë i plotë dhe i ekuilibruar nxit nxënësit të jenë të angazhuar dhe të përkushtuar jo vetëm në fazën përmbyllëse, por gjatë gjithë punës, duke e parë projektin si një përvojë të nxëni me kuptim dhe me ndikim të gjatë. Kështu ata kuptojnë se nuk punojnë vetëm për një notë apo për një prezantim të bukur, por kuptojnë mënyrën si duhet të mësojnë dhe bashkëpunojnë për të ardhmen.

Si duhet të vlerësojë mësuesi gjatë procesit?

Vlerësimi i procesit kërkon që mësuesi të jetë i pranishëm dhe i vëmendshëm gjatë gjithë fazave të projektit të nxënësve. Kjo realizohet:





- duke vëzhguar sistematikisht mënyrën si nxënësit bashkëpunojnë, ndajnë detyrat dhe diskutojnë për të marrë vendime. Kjo e ndihmon të identifikojë si po zhvillohen aftësitë e punës në grup dhe të komunikimit.
- duke bërë pyetje nxitëse e reflektuese që i drejtojnë nxënësit të shohin më thellë problemet dhe të gjejnë zgjidhje të argumentuara.
- duke lexuar dhe duke komentuar materialet e përkohshme, si planet e punës, skicat, shënimet apo tabelat ku nxënësit organizojnë të dhënat dhe idetë.
- duke kërkuar herë pas here reflektime të shkurtra, ku nxënësit tregojnë se çfarë kanë arritur, çfarë kanë hasur si vështirësi dhe si mendojnë ta vazhdojnë projektin.
- duke përdorur mjete të vogla të vetëvlerësimit ose të vlerësimit formues, që i ndihmojnë nxënësit të ndjekin vetë progresin e tyre duke u bazuar në rezultatet e pritshme të projektit.

Në këtë mënyrë, vlerësimi nuk bëhet vetëm në fund, por shtrihet gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të projektit. Kjo i motivon nxënësit të angazhohen vazhdimisht, i ndihmon të korrigjojnë drejtimin kur është e nevojshme dhe bën që në fund produkti të jetë fryt i një procesi të qëndrueshëm dhe të mirëorganizuar.

Shembull 1:

Gjatë fazës së mbledhjes së informacionit, mësuesi kalon nga grupi në grup dhe u bën pyetje si:

- Nga cilat burime i keni marrë këto të dhëna?
- Pse mendoni se këto janë më të besueshme se të tjerat?
- A keni menduar të kontrolloni edhe një burim tjetër për të verifikuar?

Pastaj shënon disa vëzhgime në fletën e tij, që i përdor më vonë kur të japë komente ose pikë.

Shembull 2:

Në një fazë të projektit, mësuesi u kërkon nxënësve të plotësojnë një fletë të shkurtër reflektimi:

- Çfarë kemi bërë deri tani?
- Cila ka qenë pjesa më e vështirë?





- Si e kemi ndarë punën në grup?

Mësuesi e lexon këtë dhe në orën tjetër u kthen disa sugjerime ose i fton të diskutojnë ku mund të përmirësohen.

Shembull 3:

Teksa nxënësit përgatisin versionin paraprak të prezantimit, mësuesi shikon strukturën dhe përdorimin e gjuhës. Ai jep komente të shkurtra me gojë ose me shkrim, p.sh.:

- Këtu mund të shtoni edhe një fakt që e keni mbledhur, për ta bërë më bindës.
- Shikoni drejtshkrimin e titullit, sepse ka një gabim.

Kjo i ndihmon nxënësit të korrigjojnë projektin para se ta prezantojnë.

Shembull 4:

Gjatë punës në grup, mësuesi shikon si bashkëpunojnë nxënësit me njëri-tjetrin, a janë të gjithë të zënë me diçka, a ndihmojnë njëri-tjetrin apo disa nuk janë aktivë dhe nuk përfshihen në projekt.

Më pas, diskuton me grupet veç e veç për disa minuta dhe pyet:

- Çfarë ka bërë secili prej jush deri tani?
- Kush e shkruan tekstin, kush merret me ilustrimet, kush me prezantimin?

Shembull 5:

Në fund të çdo faze, mësuesi shënon në një tabelë të tij të vogël se si ka ecur çdo grup për hulumtimin, bashkëpunimin dhe respektimin e afateve. Këto të dhëna i përdor më vonë kur të bëjë vlerësimin final që të mos mbështetet vetëm tek pamja e bukur e produktit të projektit në ditën e prezantimit.

6.2.Kriteret e vlerësimit të projekteve

Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit është një hap vendimtar që garanton që procesi i vlerësimit të projekteve të jetë i drejtë, i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë. Kriteret shërbejnë si një “hartë” që udhëheq si mësuesin, ashtu edhe nxënësit, duke sqaruar që





në fillim se çfarë pritet të arrihet dhe cilat janë kriteret që do të përdoren për të gjykuar punën.

Kriteret duhet të bazohen gjithmonë në qëllimin e projektit dhe në rezultatet e pritshme që synohen të përmbushen nga nxënësit. Për këtë arsye, ato nuk duhet të kufizohen vetëm te njohuritë lëndore, por të përfshijnë gjithashtu aftësitë e të menduarit kritik e krijues, përdorimin e saktë dhe të pasur të gjuhës shqipe, bashkëpunimin, organizimin e punës dhe cilësinë e paraqitjes.

Është shumë e rëndësishme që këto kriteret të ndahen me nxënësit që në fillim të projektit. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë më mirë pritshmëritë, të orientohen dhe të marrin përgjegjësi për punën e tyre, duke mos e parë vlerësimin si diçka që vjen vetëm në fund dhe vetëm nga mësuesi.

Kriteret mund të përfshijnë aspekte të tilla si:

- *Hulumtimi*: Sa mirë ka hulumtuar nxënësi (ose grupi)? Sa të përshtatshme dhe të besueshme janë burimet e përdorura dhe si janë përzgjedhur informacionet?
- *Përmbajtja*: Sa të plotë, të thelluara dhe të kuptimshme janë idetë e paraqitura? A u përgjigjen qëllimeve dhe rezultateve të pritshme të projektit?
- *Përdorimi i gjuhës shqipe dhe të shkruarit*: Sa e qartë dhe e pasur është gjuha, sa i saktë është drejtshkrimi dhe si janë ndërtuar tekstet e shkruara (ese, artikuj, poezi, prezantime)?
- *Kreativiteti dhe qasja personale*: Sa origjinal është trajtimi i temës? Sa të veçanta dhe origjinale janë idetë dhe mënyra e prezantimit?
- *Bashkëpunimi dhe angazhimi individual*: Si është ndarë puna në grup dhe sa ka kontribuar secili nxënës?
- *Paraqitja e produktit final*: Sa i plotë, i organizuar dhe i tërheqës është materiali i përgatitur dhe si është realizuar prezantimi para të tjerëve?

Për ta bërë procesin sa më transparent dhe për t'i ndihmuar nxënësit të vetëvlerësohen, këto kriteret mund të përmbledhen në një rubrikë ose tabelë të thjeshtë, që shërben njëkohësisht si mjet orientimi gjatë gjithë projektit dhe si bazë për vlerësimin përfundimtar.





Më poshtë është një tabelë me disa kriterë sugjeruese për vlerësimin e projekteve të nxënësve.

Kriteret / Pikët	0 Dobët	1 Mjaftueshëm	2 Mirë	3 Shumë mirë
Risitë dhe lidhja me jetën reale (Për shkak të rëndësisë, ky kriter mund të vlerësohet me dyfishin e pikëve.)	Nuk ka lidhje me situata reale dhe nuk paraqet risi.	Ka një lidhje të pjesshme me jetën reale dhe sjell pak elemente të reja.	Lidhet qartë me një situatë reale dhe paraqet disa ide origjinale.	Lidhet ngushtësisht me jetën reale dhe sjell ide të veçanta e inovative që çojnë në një produkt unik.
Kërkimi dhe mbledhja e informacionit	Grupi nuk ka mbledhur të dhëna ose ka përdorur burime jo të besueshme.	Grupi ka mbledhur disa të dhëna nga pak burime.	Grupi ka bërë kërkime të mjaftueshme me burime të besueshme.	Grupi ka bërë kërkime të thelluara me burime të shumëllojshme dhe të besueshme.
Përmbajtja dhe përpunimi i të dhënave	Përmbajtja është e cekët, e pasaktë ose pa analizë.	Përmbajtja është e thjeshtë, me disa të dhëna të përpunuara.	Përmbajtja është korrekte dhe të dhënat janë analizuar mirë.	Përmbajtja është e pasur, me të dhëna të përpunuara në mënyrë të qartë e të kuptueshme.
Përdorimi i gjuhës shqipe dhe të shkruarit	Produkti ose prezantimi ka shumë gabime drejtshkrimore	Ka disa gabime dhe gjuha është	Ka pak gabime, gjuha është e kuptueshme.	Gjuha është shumë e qartë, e saktë, e pasur dhe





	dhe gjuha është e varfër.	përgjithësisht e qartë.		tekstet janë të ndërtuara shumë mirë.
Kreativiteti dhe origjinaliteti	Nuk shfaq ide origjinale dhe kreativitet.	Ka pak elemente kreative, por mbetet kryesisht në qasje tradicionale dhe të njohur.	Përfshin disa ide të reja dhe mënyra të veçanta trajtimi; dëshmon përpjekje për të menduar ndryshe.	Shfaq shumë kreativitet, trajton temën në mënyrë origjinale dhe sjell ide të reja e të papritura që e bëjnë projektin unik.
Bashkëpunimi dhe angazhimi individual	Ka mungesë bashkëpunimi, disa nxënës në grup nuk kanë kontribuar.	Bashkëpunimi është i pjesshëm dhe disa nxënës tërhiqen.	Bashkëpunim i është i mirë, shumica e nxënësve kanë kontribuar.	Ka bashkëpunim të shkëlqyer, të gjithë janë të angazhuar dhe kanë ndarë përgjegjësitë gjatë projektit.
Prezantimi i projektit	Prezantimi është i paqartë, me shumë gabime dhe nuk respektohet koha.	Prezantimi është i kuptueshëm, por me disa pasaktësi dhe menaxhim mesatar të kohës.	Prezantimi është i qartë, i organizuar, me pak gabime dhe menaxhim të mirë të kohës.	Prezantimi është shumë i qartë, bindës, pa gabime, me elemente vizuale dhe menaxhim të shkëlqyer të kohës.





Përdorimi i TIK-ut	TIK-u nuk është përdorur ose është përdorur shumë pak.	Është përdorur pjesërisht, kryesisht për prezantim.	Është përdorur mirë për hulumtim dhe prezantim.	Është përdorur plotësisht në çdo fazë të projektit: hulumtim, analizë, krijim, prezantim.
Etika dhe përgjegjësia	Nuk respekton të drejtat e autorit ose vlerat shoqërore, mjedisore etj.	Respekton pjesërisht të drejtat dhe vlerat etike.	Respekton përgjithësisht të drejtat dhe vlerat etike.	Respekton plotësisht të drejtat e autorit, dhe demonstroi ndjeshmëri të lartë për vlerat shoqërore, mjedisore etj.

7. SUGJERIME PËR MËSUESIT

Ky kapitull synon të ndihmojë mësuesit me disa udhëzime që lehtësojnë organizimin e projekteve, nxisin angazhimin e nxënësve dhe rrisin cilësinë e rezultateve. Ai përmban sugjerime të vlefshme për të përballuar sfidat më të shpeshta që shfaqen në punën me projekte, si zhvillimi i kreativitetit dhe i bashkëpunimit, menaxhimi i kohës dhe i burimeve, si dhe promovimi i origjinalitetit.

Si nxitet kreativiteti dhe puna në grup?

- Jepuni mundësi nxënësve që të zgjedhin tema ose mënyra të ndryshme për të realizuar projektin. Kjo rrit motivimin dhe krijon hapësirë për ide origjinale dhe të veçanta.
- Gjatë diskutimeve, mos i gjykoni menjëherë idetë që duken të çuditshme. Shpesh nga to lindin projekte shumë origjinale.





- Organizoni takime të rregullta të grupit ku nxënësit shkëmbejnë ide, paraqesin pjesë të projektit dhe marrin feedback nga grupi e nga mësuesi.
- Kujdesuni që grupet të mos jenë të njëtrajtshme, por të bashkojnë nxënës me interesa dhe talente të ndryshme që mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme (në shkrim, në prezantim, në vizatim, në përdorimin e teknologjisë etj.).
- Krijoni një klimë miqësore, pasi nxënësit duhet të ndihen të sigurt për të shprehur idetë e tyre pa frikën e talljes apo gjykitimit.

Si menaxhohen koha dhe burimet?

- Ndhimojini nxënësit të ndajnë projektin në hapa të vegjël dhe të vendosin afate të qarta (p.sh., deri javën e ardhshme duhet të keni mbledhur të gjitha informacionet e nevojshme).
- Mbani një plan të shkurtër të projektit në klasë ku shënohen fazat dhe afatet. Kjo i mban nxënësit të vetëdijshëm se ku ndodhen dhe çfarë kanë përpara.
- Kujtoni gjithmonë se projekti duhet të jetë i arritshëm me burimet që ka shkolla dhe vetë nxënësit në dispozicion. Jepni alternativa të thjeshta për posterat, prezantimet apo videot, në varësi të mundësive.
- Kontrolloni rregullisht progresin, me pyetje të shkurtra ose me një tabelë ku nxënësit shënojnë çfarë kanë përfunduar. Kjo ndihmon të shmangen grumbullimet e punës në minutën e fundit.

Si shmangen plagjiatura dhe promovohet origjinaliteti?

- Shpjegojuni nxënësve çfarë do të thotë të kopjosh materiale nga interneti ose nga punët e të tjerëve pa i cituar.
- U mësoni nxënësve të përdorin burime dhe të bëjnë referenca të thjeshta. Nuk ka nevojë për bibliografi akademike të ndërlikuar, por për të treguar qartë nga janë marrë idetë kryesore ose citimet.
- Nxitni mendimin personal: Pyetini shpesh nxënësit: “Po ju çfarë mendoni për këtë?”, “Si do ta shpjegoni ju këtë ide me fjalët tuaja?”. Kjo i ndihmon nxënësit të dalin nga kopjimi mekanik dhe të krijojnë diçka të vetën.
- Kontrolloni pjesë të projektit gjatë procesit, jo vetëm në fund. Kjo e bën më të vështirë kopjimin dhe i nxit nxënësit të punojnë me hapa të vegjël të ndershëm.



- 
- Shpjegojuni që edhe gabimet origjinale vlejné më shumë sesa kopjimi i një materiali perfekt nga interneti. Ky është një mesazh kyç për të ndërtuar mendim kritik, krijues dhe të pavarur.

8. MJETET DHE BURIMET NDIHMËSE

Zhvillimi i projekteve kërkon përdorimin e një sërë mjetesh dhe burimesh ndihmëse që e lehtësojnë procesin e planifikimit, kërkimit, krijimit dhe prezantimit. Këto mjete duhet të zgjidhen në funksion të temës së projektit, moshës së nxënësve dhe burimeve të disponueshme në shkollë. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e mjeteve digjitale dhe materialeve praktike që mund të përdoren në mënyrë fleksibile dhe pedagogjiksht të justifikuar.

8.1. Mjete digjitale për projekte shkollore



- *Google Scholar* ofron një mënyrë të thjeshtë për të kërkuar gjerësisht literaturë shkencore: artikuj, teza, libra, abstrakte dhe opinione nga botues akademikë, shoqata profesionale, universitete dhe faqe të tjera interneti. Google Scholar ndihmon të gjendet informacion në të gjithë botën e kërkimit shkencor.

- *Khan Academy* është një platformë arsimore ndërkombëtare që ofron ushtrime praktike, video mësimore dhe një panel të personalizuar të të nxënit, duke u mundësuar nxënësve të studiojnë me ritmin e tyre, si në klasë ashtu edhe jashtë saj. Ajo mbulon një gamë të gjerë lëndësh që nga arsimi fillor deri në arsimin e mesëm të lartë, duke përfshirë matematikën, shkencat, gjuhën, TIK-un, historinë, ekonominë etj. Platforma fokusohet te përvetësimi i plotë i njohurive, duke ndihmuar nxënësit të ndërtojnë themele të forta që u nevojiten për të arritur sukses në arsimin e lartë dhe në karrierën e tyre të ardhshme.





Google Workspace

- *Google Workspace* është një grup aplikacionesh të Google që përfshin ndër të tjera Docs (për shkrim), Slides (për prezantime) dhe Sheets (për tabela e grafikë). Këto mjete janë shumë të dobishme për projektet në lëndët e gjuhës dhe të letërsisë, sepse:

Në Google Docs

- ✓ Nxënësit mund të shkruajnë ese, tregime të shkurtra, artikuj ose poezi, duke punuar njëkohësisht në të njëjtin dokument dhe duke parë në kohë reale ndryshimet që bën secili.
- ✓ Mësuesi mund të komentojë, të bëjë pyetje ose të sugjerojë përmirësime në strukturën e tekstit apo në përdorimin e fjalorit.

Google Slides

- ✓ Nxënësit mund të krijojnë prezantime multimediale për të pasqyruar rezultatet e një projekti gjuhësor ose letrar.

Google Sheets

- ✓ Edhe pse më pak i lidhur drejtpërdrejt me gjuhën, *Google Sheets* është shumë i dobishëm për të organizuar të dhënat e mbledhura gjatë projekteve ndërlëndore ku fusha e gjuhës bashkohet me hulumtimin shoqëror ose historik.
- ✓ Për shembull, në një projekt mbi etikën në komentet online, nxënësit mund të përdorin Sheets për të kategorizuar llojet e komenteve (pozitive, neutrale, negative, fyese) që kanë analizuar dhe më pas të paraqesin një tabelë ose grafik që tregon përqindjet.
- ✓ Po ashtu mund të përdoret për të planifikuar dhe për të ndjekur hapat e projektit, duke vendosur datat, detyrat dhe emrat e personave përgjegjës.

- **Padlet** është një “mur digjital” bashkëpunues ku nxënësit dhe mësuesit mund të mbledhin, organizojnë dhe ndajnë ide, shënime, foto, video apo dokumente. Në projektet e gjuhës dhe të letërsisë, ai shërben për të mbledhur materiale fillestare (p.sh., fjalë dialektore, komente mbi tekste letrare), për të krijuar albume leximi me reflektime





dhe ilustrime, si dhe për të ndjekur hapat e punës së grupit. Padlet e bën procesin të dukshëm për të gjithë, forcon bashkëpunimin dhe nxit pjesëmarrjen aktive të çdo nxënësi.

- **Trello** është një mjet online për organizimin vizual të punës nëpërmjet tabelave, kolonave dhe kartelave. Në projektet e gjuhës dhe të letërsisë, *Trello* ndihmon nxënësit të planifikojnë hapat, të ndajnë detyrat sipas anëtarëve të grupit dhe të ndjekin afatet, duke parë qartë çfarë është bërë dhe çfarë mbetet për t'u realizuar. Kjo e bën procesin më të strukturuar, rrit përgjegjësinë individuale dhe forcon aftësitë e menaxhimit të projektit.



- **Canva** (në versionin Edu) është një program krijimi vizual që u lejon nxënësve dhe mësuesve të hartojnë postera, infografikë, revista digjitale, prezantime dhe madje



edhe video të shkurtra, duke përdorur modele të gatshme profesionale. Në projektet e gjuhës dhe të letërsisë, Canva ndihmon nxënësit të pasqyrojnë në mënyrë krijuese tekstet e shkruara, reflektimet ose sloganet sensibilizuese, duke i bërë ato më tërheqëse dhe të kuptueshme për audiencën. Ky mjet zhvillon si të shkruarit, ashtu edhe aftësitë

vizuale dhe digjitale, duke përforcuar mesazhet e projektit.



- **Piktochart** dhe **Vennngage** janë programe të specializuara për ndërtimin e infografikëve, që ndihmojnë nxënësit të përmbledhin dhe të vizualizojnë të dhëna, fakte ose ide në mënyrë të qartë dhe tërheqëse. Në projektet e gjuhës dhe të letërsisë, këto mjete mund të përdoren për të shfaqur analiza të teksteve, statistika nga sondazhe të kryera për tema sociale ose kulturore apo





për të ilustruar në mënyrë vizuale konceptet kryesore të një projekti. Kështu, nxënësit jo vetëm organizojnë më mirë informacionin, por mësojnë edhe si ta komunikojnë atë në forma të kuptueshme për audienca të ndryshme.

- **Prezi** është një program për krijimin e prezantimeve dinamike dhe vizualisht të ndërveprueshme që ndryshe nga prezantimet lineare klasike, i lejon nxënësit të lëvizin lirshëm midis temave dhe nën-temave në një hartë të madhe konceptuale. Kjo mënyrë vizuale i ndihmon të shpjegojnë lidhjet mes ideve në mënyrë më të gjallë dhe tërheqëse. Në projektet e gjuhës dhe të letërsisë, Prezi mund të përdoret për të paraqitur analizën e një poezie ose të një tregimi duke nxjerrë në pah simbolet, mesazhet dhe ndërlidhjet ose për të ndërtuar një rrugëtim vizual mbi jetën dhe veprën e një autori.



- **Genially** është një platformë për të krijuar prezantime, postera, infografikë dhe materiale të tjera digjitale ndërvepruese. Përveç paraqitjes pamore tërheqëse,



Genially lejon shtimin e elementeve të klikueshëm, animacioneve dhe lidhjeve, duke e bërë punën e nxënësve më dinamike dhe më

ndërvepruese. Në projektet e gjuhës dhe të letërsisë, nxënësit mund ta përdorin për të ndërtuar prezantime të larmishme të analizave letrare, për të paraqitur rrëfime të shkruara nga vetë ata me ilustrime dhe efekte apo për të krijuar “harta të mendjes” së temave dhe të elementeve të tjera brenda një veprë letrare.

- **Plectica** Plectica është një mjet online i cili ndihmon për të krijuar harta të koncepteve dhe diagrama. Plectica është shumë i thjeshtë për t’u përdorur dhe lejon mësuesit dhe nxënësit të organizojnë dhe shpërndajnë





informacionin me lehtësi. Hartat e koncepteve dhe diagramet mund të përdoren individualisht ose të shpërndahen dhe të punohen në bashkëpunim me të tjerë. Informacioni mund të organizohet në një listë, kolonë ose si tekst dhe mund të zhvendoset lehtësisht vetëm duke tërhequr kursorin. Nxënësit mund t'i lidhin figurat me njëra-tjetrën me një shigjetë. Të gjitha ndryshimet ruhen automatikisht. Plectica është i shkëlqyeshëm për stuhi mendimesh në një klasë kur punohet si me grupe të mëdha ashtu dhe me grupe më të vogla. Ky mjet i lejon nxënësit të ndryshojnë llojin e shkrimit, ngjyrat si edhe të shtojnë komente, shënime, imazhe e media të tjera.

- **Ayoo** është një platformë digjitale që ofron tri mjete të ndryshme, të cilat mund të lidhen në mënyra fleksibël: hartat e koncepteve, një tabelë detyrash dhe një tabelë



interaktive. Qasja pamore dhe funksionet e saj të filtrit mund të jenë veçanërisht të dobishme për të punuar me grupe të ndryshme. Nxënësit mund të krijojnë harta të koncepteve ndërvepruese për stuhi mendimesh, mund të ndryshojnë ngjyrat e sfondit dhe të bëjnë ndryshime të hartave si dokumente dhe imazhe në Word ose Pdf. Mësuesit dhe nxënësit mund të krijojnë gjithashtu lista detyrash të orientuara nga

koha që mund të ndahen në tri kategori (tani, tjetër, së shpejti). Në tabelën interaktive, mësuesit dhe nxënësit mund të shtojnë përmbajtje interaktive, të tilla si shënime me ngjitje, lista kontrolli, grafikë ose imazhe. Ayoo gjithashtu lejon nxënësit të caktojnë vetë detyrat e tyre.



-**Hero Forge** është një krijues avatar dhe i thjeshtë për t'u përdorur. Ky mjet i lejon mësuesit dhe nxënësit të shfrytëzojnë krijimtarinë e tyre duke vizatuar personazhe virtuale që mund të përdoren në veprimtaritë mësimore. Falë veçorive të shumta të Hero Forge dhe teknologjisë 3D,





nxënësit do të jenë në gjendje të zgjedhin llojin dhe gjininë e avatarit të tyre, së bashku me ngjyrën e flokëve, syve dhe shumë më tepër.

Hero Forge është një mjet shumë interesant që i bën orët mësimore më krijuese dhe më tërheqëse. Orët e mësimi të gjuhës bëhen më përfshirëse dhe argëtuese kur përdoret Hero Forge, pasi mësuesi dhe nxënësit mund të integrojnë lehtësisht krijimin e personazheve të ndryshëm në tema të tilla si ndryshimet klimatike, të drejtat e njeriut, media, qytetërimet e lashta të botës etj. Për më tepër, krijimi i avatarëve me Hero Forge është plotësisht falas dhe mjeti lejon që nxënësit t'i ruajnë heronjtë e krijuar dhe t'i ndajnë ato me të tjerët. Nxënësit mund të blejnë avatarët e tyre në versionin plastik 3D ose prej bronzi për një tarifë të caktuar, megjithëse kjo është një veçori që shumica e mësuesve dhe nxënësve nuk do të jenë të interesuar ta përdorin.

- **Pitch** është një mjet për të krijuar prezantime interaktive. Pitch ofron modele (shabllone) dhe stile tërheqëse për nxënësit për të punuar individualisht ose në



grup. Mësuesit dhe nxënësit mund të shtojnë afate kohore, grafikë (*këto mund të importohen nga Google Sheets dhe Google Analytics*), ikona, ngjitëse, imazhe etj. Anëtarët e grupit janë në gjendje të lidhin kamerat e tyre dhe të komunikojnë gjatë prezantimit. Nxënësit mund t'ju caktojnë slajde anëtarëve të tjerë të grupit, t'u shtojnë statuse slajdeve rreth fazave të ndryshme në të cilat ndodhen (për shembull: “për të bërë”, “në zhvillim” ose “mbaruar”), të shkruajnë komente, të shtojnë reagime, të lënë shënime tek prezantimi, të ndajnë prezantimin dhe të ftojnë anëtarët e tjerë gjithashtu.

Vlerësimi: Pitch është një mjet prezantimi i thjeshtë për t'u përdorur i cili ofron shumë mundësi redaktimi. Ai është veçanërisht i përshtatshëm për mësuesit dhe nxënësit që duan t'i japin një pamje të re prezantimeve të tyre në klasë. Pitch është perfekt për punën në grup.





- *Google Forms* është një mjet online që u mundëson nxënësve dhe mësuesve të hartojnë pyetësorë, të mbledhin të dhëna dhe t'i analizojnë ato automatikisht. Ky mjet është veçanërisht i dobishëm në projektet e gjuhës dhe të letërsisë kur nxënësit kryejnë sondazhe për tema sociale, kulturore apo mbi zakonet e leximit, duke i ndihmuar të organizojnë të dhënat në mënyrë të strukturuar dhe t'i interpretojnë përmes grafikëve. Për më tepër, mund të përdoret edhe për të mbledhur reflektime ose opinione të pjesëmarrësve pas përfundimit të projekteve.



8.2. Burime dhe materiale të tjera të dobishme

Edhe pse teknologjia ndihmon në shumë faza të projektit, përdorimi i materialeve të thjeshta shkollore është po aq i rëndësishëm, veçanërisht në fazat e planifikimit, vizualizimit dhe reflektimit.

- Tabela planifikimi (*afate, detyra, faza të punës*) për të ndjekur në mënyrë të organizuar hapat e projektit.
- Letra ngjitëse për mbledhjen e ideve ose për strukturimin e përmbajtjes sipas temave të caktuara.
- Kartonë të bardhë, letër formati A4, fletë flip-chart për skicim, hartë mendore, postera konceptuale etj.
- Materiale artizanale (ngjyra, ngjitës, gërshërë, ilustrime të printuara) për ndërtimin e prototipeve ose pjesëve vizuale të produktit të projektit.
- Fletë reflektimi individuale dhe në grup për të mbledhur mendimet, përvojat dhe vetëvlerësimin gjatë procesit.

8.3. Parime për përzgjedhjen e mjeteve

Për të qenë efektive dhe të dobishme, mjetet dhe burimet që përdoren në një projekt, duhet të përmbushin këto kritere:

- Të jenë të aksesueshme dhe të përdorshme nga të gjithë nxënësit.
- Të përshtaten me qëllimet dhe rezultatet e pritshme të projektit.
- Të nxisin të menduarit e pavarur, organizimin dhe krijimtarinë.
- Të respektojnë të dhënat personale dhe etikën e përdorimit të informacionit digjital.





9. FORMATI I PLANIT TË NJË PROJEKTI

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

Lënda: Shënohet lënda në të cilën zhvillohet projekti.

Klasa: Shënohet klasa në të cilën zhvillohet projekti.

Tema e projektit: Përcaktohet tema kryesore e projektit, e vendosur nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, duke pasur parasysh lidhjen me jetën reale dhe me interesat e nxënësve.

Rezultatet e të nxënit: Përcaktohen njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet/vlerat që pritet të zhvillohen tek nxënësit gjatë projektit.

Konceptet kryesore: Listohen konceptet dhe nocionet më të rëndësishme që nxënësit do të përdorin dhe do të thellohen gjatë realizimit të projektit.

Kohëzgjatja e projektit / orët mësimore: Tregohet periudha kohore dhe numri i orëve të planifikuara për realizimin e projektit.

Klasa/t pjesëmarrëse: Përcaktohen klasa ose klasat që do të përfshihen në projekt (p.sh.: klasat 10¹ dhe 10²).

Partnerët: Shënohen partnerët e mundshëm që mund të përfshihen në projekt, si individë ose institucione që kontribuojnë në realizimin e tij.

Veprimtaritë kryesore: Përshkruhen aktivitetet dhe hapat kryesorë që do të ndërmerren gjatë realizimit të projektit, duke përfshirë planifikimin, kërkimin, përpunimin dhe paraqitjen.

Burimet kryesore të informacionit: Identifikohen burimet që nxënësit do të përdorin për të mbledhur informacionin e nevojshëm, me udhëzimet e mësuesit.

Tematika e orëve të planifikuara: Shënohet tema për çdo orë të parashikuar të projektit, duke organizuar në mënyrë të qartë rrjedhën e punës.

Përshkrimi i produktit të projektit: Përshkruhet lloji i produktit final që do të realizohet në përfundim të projektit dhe mënyra se si do të prezantohet.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi: Përcaktohen kriteret mbi të cilat do të vlerësohet projekti, të cilat duhet t'u komunikohen nxënësve që në fillim, si dhe mënyrat për të nxitur reflektimin mbi të gjithë procesin e punës.





10. MODELE PROJEKTESH

10.1. Model projekti për klasën e gjashtë

Lënda: Gjuha shqipe

Klasa: VI

Tema e projektit: Bimët dhe historitë e tyre

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi:

- emërton dhe përshkruan disa bimë të zakonshme në mjedisin përreth (oborr, lagje, park).
- shpjegon me fjalët e veta rëndësinë e legjendave, përrallave, fjalëve të urta dhe besimeve popullore në kulturën shqiptare.
- shkruan një tekst të shkurtër krijues me temë nga natyra, të ndarë në 3–5 paragrafë dhe të pasuruar me figura të thjeshta letrare (epitet, krahasim, personifikim), për të shprehur mendime dhe ndjenja në mënyrë origjinale dhe të kuptueshme.
- ilustron tekstin përmes vizatimit ose fotografisë, duke ruajtur lidhjen dhe përputhshmërinë mes përshkrimit dhe imazhit.
- përdor TIK-un për të përpunuar tekstin dhe për të përgatitur një prezantim të thjeshtë digjital (p.sh., powerpoint, padlet, Word).
- vlerëson punën e vet dhe të bashkëmoshatarëve përmes një reflektimi të udhëhequr nga mësuesi.
- bashkëpunon në grup për të krijuar një produkt përfundimtar të strukturuar, tërheqës dhe të përdorshëm nga të tjerët.
- prezanton produktin përfundimtar (album fizik ose digjital), duke përshtatur gjuhën me qëllimin e komunikimit dhe me dëgjuesit.

Njohuritë dhe konceptet kryesore:

- Figura letrare: epiteti, krahasimi dhe personifikimi si elementë të përshkrimit të figurshëm.





- Përrallat, legjendat³, fjalët e urta ⁴dhe besimet popullore për lulet dhe bimët.
- Struktura e tekstit letrar ose e tekstit jolettrar: hyrje, zhvillim dhe përfundim; organizimi i ideve në paragrafë të qartë dhe të lidhur logjikisht.
- Ilustrimet (*vizatim apo fotografi*) për të plotësuar ose për të ilustruar kuptimin e tekstit.
- Njohuri bazë për përpunimin dhe paraqitjen e tekstit dhe ilustrimit në formë digjitale (p.sh., PowerPoint, Padlet, Word).
- Koncepti i projektit si proces bashkëpunimi dhe ndarjeje përgjegjësisë.
- Reflektimi si pjesë e të nxënës.

Kohëzgjatja e projektit / orët mësimore: 8 orë të shpërndara përgjatë vitit shkollor

Partnerët:

- Mësuesi i gjuhës shqipe që udhëheq projektin në të gjitha fazat: planifikon, udhëzon nxënësit në shkrimin e teksteve, përzgjedh materialet letrare mbështetëse dhe koordinon prezantimin përfundimtar.
- Mësuesi i biologjisë që mbështet nxënësit në identifikimin dhe përshkrimin e bimëve të zakonshme në mjedisin përreth, duke ofruar njohuri themelore për veçoritë e tyre natyrore.

³ *Gojëdhëna për trëndafilin:* Thuhet se trëndafili ka lindur nga lotët e një vajze që qante dashurinë e humbur. Lotët e saj ranë mbi tokë dhe aty lindi trëndafili me gjemba, si shenjë e dhimbjes së saj.

⁴ S'bëhet deng me rrush.

Dardha e ka bishtin prapa.

Duket bima që kur mbin.

Kush rri nën dardhë, i ha kokrrat.

Mos mburr degët pa parë rrënjët.

Një dru i shtrembër rrëzon (prish) gjithë stuvën.

Hardhia e bën rrushin, ferra merr uratën.

S'prishet dasma për një limon.

Sa më i gjatë është lisi, aq më shumë e zë era.

Pritëm për mana e na dolën thana.

S'bëhet lundra me dru marene.

Mollët i qëro, dardhët i numëro.

Kur s'ha kumbulla, s'të mpihen dhëmbët.

Njeriu që vetëm për vete punon, është si dru që pemë s'lëshon.

Sheh rrushi rrushin e piqet.

Me një lule (me një dallëndyshe) s'vjen pranvera.





- Prindërit dhe anëtarë të tjerë të familjes që ndajnë gojëdhëna, përralla apo besime popullore nga zona, duke kontribuar në pasurimin e përmbajtjes kulturore.
- Mësuesi i artit pamor që ndihmon nxënësit në realizimin e ilustrimeve për tekstet letrare ose joletrare, me vizatime ose kompozime vizuale.
- Mësuesi i TIK-ut që mbështet nxënësit në përpunimin dhe paraqitjen digjitale të materialeve.
- Nxënës nga klasa të tjera që marrin pjesë si lexues, komentues ose dëgjues gjatë prezantimit të produktit përfundimtar.

Veprimtaritë kryesore:

- Vëzhgim i mjedisit përreth (oborr i shkollës, lagje, park) dhe fotografim i bimëve të ndryshme që gjenden aty.
- Diskutim në klasë mbi emrat dhe veçoritë e bimëve të fotografuara nga nxënësit, krahasimi dhe ndarja e njohurive të para.
- Hulumtim i thjeshtë në burime tradicionale (familjarë, libra) dhe burime online të kontrolluara si <https://shkolladigjitale.al>, <https://kids.britannica.com>⁵ ose materiale të përzgjedhura nga mësuesi në një faqe Padlet të dedikuar.
- Lexim i gojëdhënave, përrallave, legjendave ose besimeve popullore të sjella nga mësuesi dhe diskutim mbi vlerat që ato përcjellin.
- Shkrim i një teksti të shkurtër letrar ose joletrar për një nga bimët ose nga lulet, duke përdorur figura letrare si epiteti, krahasimi dhe personifikimi.
- Ilustrim i tekstit me imazhe ose me foto të bërë gjatë vëzhgimit.
- Punë në grup për krijimin e një albumi, i cili përmban tekstet e nxënësve, fotografitë dhe ilustrimet përkatëse, të organizuara në faqe të titulluara, të shoqëruara me emrin e nxënësit dhe klasën.
- Prezantim i albumit në klasë ose në një hapësirë të dukshme të shkollës dhe lexim me zë i fragmenteve të përzgjedhura para bashkëmoshatarëve dhe të tjerëve që mund të jenë të pranishëm.

Burimet kryesore të informacionit:

⁵ <https://kids.britannica.com/kids/article/rose/353730>





- Vëzhgimi i drejtpërdrejtë i bimëve në oborrin e shkollës, në lagje ose në mjedise të tjera natyrore të afërta.
- Rrëfime të vogla, gojëdhëna ose besime popullore të marra nga prindërit, gjyshërit apo të afërm të familjes.
- Libra me përralla, legjenda dhe besime popullore nga folklori shqiptar, të siguruar nga biblioteka e shkollës dhe të përzgjedhura nga mësuesi.
- Materiale online të përzgjedhura nga mësuesi dhe të shpërndara përmes platformës Padlet (kur është e mundur), të ndërtuara në gjuhë të thjeshtë dhe të përshtatshme për nxënësit e klasës së gjashtë.
- Artikuj të thjeshtë dhe të përshtatur nga *Google Scholar*, të përzgjedhur nga mësuesi për tema të lidhura me botën bimore ose trashëgiminë kulturore.
- Video edukative nga *Khan Academy*, që lidhen me temën e natyrës dhe ndërveprimit të njeriut me mjedisin.
- Modele të teksteve letrare tradicionale të ofruara nga mësuesi si bazë për shkrimin krijues.

Tematika e orëve të planifikuara:

Orët	Tema	Çfarë ndodh në klasë?	Puna e pavarur / Prezantimi i nxënësit
1	Prezantimi i temës së projektit, ndarja e grupeve dhe përcaktimi i detyrave për secilin grup.	Mësuesi prezanton qëllimin dhe fazat e projektit, diskuton me nxënësit për rëndësinë e temës (<i>bimët dhe rrëfimet popullore</i>) dhe shpjegon rezultatet e pritshme të të nxënësit. Nxënësit ndahen në grupe, ku çdo grup ka një detyrë specifike dhe produkt përfundimtar të vetin (<i>tekste krijuese dhe ilustrime për një bimë të veçantë</i>). Çdo grup do	Çdo nxënës fotografon 1–2 bimë në lagje ose në oborrin e shkollës dhe përgatit një përshkrim të shkurtër gojor që do ta ndajë në grup. Kjo shërben si bazë për përzgjedhjen e bimës/ve që secili grup do të përpunojë në tekstin dhe ilustrimin e vet.





		të përgatisë dhe do të prezantojë në fund punën e vet, si pjesë e albumit të përbashkët. Zhvillohet një diskutim i lirë mbi njohuritë që nxënësit kanë për bimët në mjedisin e tyre.	
2	Leximi i krijimeve folklorike si gojëdhëna, përralla, fjalë të urta etj., për lulet dhe bimët.	Mësuesi sjell për lexim gojëdhëna, përralla, fjalë të urta ose besime popullore që lidhen me bimët. Nxënësit i lexojnë dhe analizojnë në mënyrë të thjeshtë përmbajtjen, mesazhin, personazhet dhe figurat letrare që ato përmbajnë. Këto krijime shërbejnë si model dhe burim frymëzimi për tekstet që nxënësit do të shkruajnë më pas.	Nxënësi hulumton ose pyet familjarët për ndonjë krijim popullor që lidhet me bimët (<i>një përrallë, gojëdhënë ose fjalë të urtë</i>) dhe e sjell për ta ndarë me grupin në klasë.
3	Shkrimi i teksteve krijuese.	Mësuesi udhëzon nxënësit për strukturën e një tregimi të shkurtër (hyrje, zhvillim, përfundim) dhe për përdorimin e figurave letrare si epiteti, krahasimi dhe personifikimi. Nxënësit fillojnë të shkruajnë tekstin e tyre krijues, të frymëzuar nga një bimë e përzgjedhur dhe nga krijimet popullore të	Nxënësi përfundon tekstin e vet në shtëpi, e redakton sipas komenteve të mësuesit dhe e lexon në klasë si draft për diskutim. Teksti më pas do të përgatitet për t'u përfshirë në albumin e përbashkët të projektit.





		diskutuara më parë. Tekstet krijohen nga nxënësit dhe komentohen nga mësuesi për përmirësim.	
4	Ilustrimi me vizatime ose përgatitja e fotove të përzgjedhura.	Mësuesi udhëzon nxënësit si të ilustrojnë tekstin e tyre në mënyrë kuptimplote, duke ruajtur lidhjen me përmbajtjen letrare. Nxënësit mund të zgjedhin midis dy mënyrave të ilustruarit: - të vizatojnë në klasë bimën ose skenën nga tregimi i tyre, <i>Ose</i> - të përpunojnë fotografinë e bërë më parë, duke e pasuruar me detaje vizuale përmes platformave si <i>Canva Edu</i>.	Nxënësit përgatisin ilustrimet (vizatime ose foto të përpunuara) dhe i shpjegojnë në klasë, duke treguar se si lidhen me tekstet e tyre. Punimet përfundimtare do të përdoren në faqet përkatëse brenda të albumit të projektit.
5 - 6	Fletët e natyrës: Nga gojëdhënat te krijimi im.	Nxënësit punojnë në grupe për ndërtimin e prezantimit final në Google Slides ose Padlet, duke përfshirë krijimet e tyre letrare dhe ilustrimet përkatëse. Në produkt mund të përfshihen gjithashtu edhe disa nga krijimet folklorike më përfaqësuese të zonës. Detyrat ndahen përmes Trello.	Nxënësit përfundojnë faqet e prezantimit dhe paraqesin versionin paraprak për komente nga bashkëmoshatarët dhe nga mësuesi.





7 - 8	Prezantimi i produktit final.	Punimet përfundimtare të nxënësve (teksti dhe ilustrimi përkatës) vendosen në një hapësirë të dukshme të klasës ose të shkollës, duke krijuar ekspozitën me titullin <i>“Fletët e natyrës: Nga gojëdhënat te krijimi im”</i> . Çdo grup paraqet versionin final të krijimit/eve të vet, që përfshin një tekst të strukturuar dhe një ilustrim shoqërues. Mësuesi nxit reflektimin mbi përvojën e të mësuarit përmes pyetjeve të ndryshme.	Nxënësit lexojnë me zë të lartë fragmente të zgjedhura nga krijimi i tyre, duke treguar lidhjen mes gojëdhënave të përdorura si frymëzim dhe tekstit të tyre personal. Ata ndajnë gjithashtu me klasën se çfarë kanë mësuar gjatë procesit: mbi natyrën, trashëgiminë kulturore dhe mënyrën se si mund të shprehin mendimet e tyre përmes gjuhës së figurshme dhe ilustrimeve pamore. Në fund, nxënësit mund të plotësojnë një fletë të shkurtër reflektimi individual.
-------	-------------------------------	---	---

Përshkrimi i produktit të projektit:

“Fletët e natyrës: Nga gojëdhënat te krijimi im” është një ekspozitë e krijuar nga nxënësit, e përbërë nga:

- Tekste të shkruara në formën e personifikimeve ose historive imagjinare të frymëzuara nga natyra dhe nga folklori shqiptar.
- Ilustrime përkatëse (vizatime ose fotografi të përpunuara) që pasqyrojnë, ilustrojnë ose plotësojnë përmbajtjen e çdo teksti.
- Krijime popullore të zgjedhura (gojëdhëna, fjalë të urta, besime) që kanë shërbyer si burim frymëzimi.

Ky produkt përmbledhet në një *album të përbashkët të klasës*, i cili vendoset në një hapësirë të dukshme të shkollës (*korridor, hyrje, kënd leximi*) dhe shërben si:





- Një material që nxënësit e klasave të tjera mund ta lexojnë, ta shikojnë dhe të reflektojnë.
- Mjet edukativ dhe frymëzues që promovon trashëgiminë kulturore, si dhe përkushtimin dhe krijimtarinë e nxënësve.
- Model për integrimin ndërlëndor, ku gjuha, biologjia dhe TIK-u bashkohen në një produkt të vetëm.

Versioni digjital i ekspozitës, nëse lejon kushtet dhe mundësitë në shkollë, ndërtohet nga vetë nxënësit në *Padlet*, *Google Slides* ose në një blog të shkollës, i cili mund të ndahet edhe në faqen zyrtare të shkollës apo rrjetet sociale për të rritur shikueshmërinë dhe përfshirjen komunitare.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi gjatë këtij projekti është formues (për të nxënë) dhe përfundimtar (i të nxënësve), duke ndjekur ecurinë e nxënësve në të gjitha fazat: hulumtim, krijim, bashkëpunim dhe prezantim.

Vlerësimi për të nxënë, gjatë gjithë ecurisë së projektit:

- Pjesëmarrja aktive në diskutime dhe në punën në grup.
- Aftësia për të përdorur burime të ndryshme (gojore, të shkruara dhe digjitale).
- Respektimi i afateve dhe i detyrave të caktuara.
- Bashkëpunimi dhe ndarja e përgjegjësisë në grup.
- Zgjidhja e problemeve.

Vlerësimi i të nxënësve (me rubrikë vlerësimi):

- Riset dhe lidhja me jetën reale
- Kërkimi dhe mbledhja e informacionit
- Përmbajtja dhe përpunimi i të dhënave
- Përdorimi i gjuhës shqipe dhe të shkruarit
- Kreativiteti dhe origjinaliteti
- Bashkëpunimi dhe angazhimi individual
- Prezantimi i projektit
- Përdorimi i TIK-ut
- Përgjegjësia për detyrat dhe sjellja në grup





Vetëvlerësimi dhe reflektimi i nxënësit:

- Çfarë mësova gjatë këtij projekti?
- Çfarë më pëlqeu më shumë dhe pse?
- Me cilën pjesë të punës sime jam më krenar?
- Si funksionoi puna në grup?

10.2. Model projekti për klasën e shtatë

Lënda: Gjuha shqipe

Klasa: VII

Tema e projektit: Të gjithë për njëri-tjetrin

Rezultatet e të nxënës:

Nxënësi:

- identifikon dhe përpunon informacione të mbledhura përmes vëzhgimit, bisedave ose pyetësorëve të thjeshtë, për të kuptuar nevojat e një bashkëmoshatari që ka vështirësi për t'u përfshirë.
- shkruan tekste të shkurtra joletrare, të bazuara në situata reale, me qëllim që të ndihmojë, sqarojë ose udhëzojë.
- reflekton përgjegjësi personale në krijimin e një klime mirëkuptimi dhe gjithëpërfshirjeje ndaj të tjerëve në klasë.
- bashkëpunon në mënyrë aktive me nxënësit e tjerë për hartimin e një produkti konkret me përdorim të drejtpërdrejtë në shkollë që i shërben përfshirjes së fëmijëve në nevojë.

Konceptet kryesore:

- Llojet dhe funksionet e teksteve praktike: udhëzues, njoftime, mesazhe, fletë informuese.
- Përdorimi i fjalorit të përshtatshëm për kontekstin: gjuhë e kuptueshme, brenda rregullave të komunikimit dhe e saktë.
- Elementet gjuhësore të komunikimit: përdorimi i fjalëve inkurajuese, formulimi i sugjerimeve, shmangia e paragjykitimit.





- Format e ndërveprimit gjuhësor në mjediset shkollore: komunikimi mes bashkëmoshatarëve në situata shoqërore dhe mësimore.
- Përdorimi i drejtë i gjuhës: gjuhë standarde, rregulla gramatikore dhe rregulla drejtshkrimore.
- Struktura e tekstit të thjeshtë udhëzues: titulli, hyrja, hapat/këshillat, përfundimi.
- Struktura dhe tiparet kryesore të një teksti: ndarja në pjesë, renditja e ideve, qartësia e mesazhit.

Kohëzgjatja e projektit / orët mësimore: 9 orë mësimore

Partnerët:

- Mësuesi i qytetarisë për të ndihmuar në trajtimin e temave të gjithëpërfshirjes dhe të bashkëjetesës me të tjerët.
- Mësuesi i TIK-ut për të ndihmuar në realizimin e versionit digjital të udhëzuesit dhe përdorimin e platformave dhe të aplikacioneve të përshtatshme.
- Mësues ndihmës për të sjellë perspektivën dhe nevojat konkrete të nxënësve me aftësi të kufizuara.
- Psikologu i shkollës për të dhënë këshillim mbi formulimin e mesazheve inkurajuese dhe mënyrat e sjelljes mbështetëse.
- Përfaqësues nga Qeveria e Nxënësve për të pasqyruar problematikat dhe nevojat e ndryshme të nxënësve.
- Prindër si bashkëpunëtorë në krijimin e një klime miqësore dhe mbështetëse për të gjithë fëmijët.

Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim në klasë për të përcaktuar temën, qëllimin dhe rëndësinë e projektit në kontekstin e gjithëpërfshirjes në klasë dhe në shkollë.
- Hulumtim për përmbajtjen e udhëzuesit, përmes shqyrtimit të literaturës ndihmëse, konsultimeve me psikologun e shkollës dhe me mësuesin ndihmës për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara, të nxënësve romë ose të nxënësve të sapoardhur në shkollë.





- Formulim i rubrikave kryesore të udhëzuesit (komunikimi, ndihma në klasë, mesazhet inkurajuese etj.).
- Ndarja e klasës në grupe sipas rubrikave dhe planifikimi i përmbajtjes që do të hartojë çdo grup.
- Punë në grupe: secili grup përgatit rubrikën e vet, me përmbajtje të qartë dhe të kuptueshme, duke përdorur ilustrime, skema, simbole dhe formulime të përshtatshme për bashkëmoshatarët.
- Bashkërendimi dhe organizimi i udhëzuesit final: grupet bashkërendojnë punën e tyre në një strukturë të përbashkët.
- Prezantimi i produktit përfundimtar: çdo grup prezanton rubrikën e vet në klasë, duke sqaruar përdorimin praktik dhe ndikimin që pritët të ketë.
- Vendosja e udhëzuesit në klasë në një vend të dukshëm dhe ndarja e versionit digjital në rrjetet sociale dhe në format e tjera të komunikimit me klasën ose me shkollën.
- Vlerësimi dhe reflektimi final mbi procesin e punës, rolin e çdo grupi, si dhe rëndësinë e mbështetjes ndaj bashkëmoshatarëve.

Burimet kryesore të informacionit:

- Biseda me psikologun e shkollës, për të kuptuar mënyrat e mbështetjes emocionale dhe sociale ndaj nxënësve me nevoja të veçanta.
- Biseda me mësuesin ndihmës, për të marrë informacione mbi mënyrat e komunikimit dhe përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara ose me vështirësi në të nxënë.
- Përvoja personale e nxënësve, si vëzhgime në klasë, kujtime ose përballje me situata reale përjashtimi ose mbështetjeje.
- Rregullorja e shkollës dhe dokumentet e tjera për etikën, sjelljen dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve.
- Materiale informuese dhe edukative nga platforma zyrtare si: Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, UNICEF Albania, Save the Children etj., që ofrojnë udhëzime për gjithëpërfshirjen dhe të drejtat e fëmijëve.





- Literaturë me përmbajtje të thjeshtë, si broshura ose video edukative në lidhje me gjithëpërfshirjen dhe mbështetjen sociale.
- Modele fletëpalosjesh ose postera mbështetës, të përdorura në shkolla të tjera që mund të shërbejnë si frymëzim për rubrikat e udhëzuesit.

Tematika e orëve të planifikuara:

Orët	Tema	Çfarë ndodh në klasë?	Puna e pavarur / Prezantimi i nxënësit
1	Prezantimi i projektit dhe gjithëpërfshirja në shkollë.	- Mësuesi diskuton me nxënësit për projektin që duhet të zhvillojnë gjatë klasës së shtatë, temën, qëllimin etj. Nxënësit propozojnë tema të ndryshme. - Mësuesi pas diskutimit prezanton temën dhe qëllimin e projektit: hartimi i një materiali mbështetës për bashkëmoshatarët me aftësi të kufizuara ose me vështirësi përfshirjeje në shkollë. - Diskutohet mbi përvojat që mund të kenë nxënësit në klasë apo në shkollë me fëmijë që kanë nevojë për ndihmë në lexim, në orientim, në përfshirje sociale etj.	- Nxënësit bisedojnë me familjarët ose kujtojnë situata reale ku ata ose dikush që njohin ka ndihmuar ose është ndihmuar në klasë apo në shkollë. - Nxënësit sjellin një përvojë personale për ta ndarë në klasë në orën e dytë. - Grupet sjellin sugjerime për strukturën e udhëzuesit duke u bazuar në nevojat që kanë identifikuar.





		- Mësuesi drejton një bashkëbisedim mbi rëndësinë e komunikimit të sjellshëm dhe mbështetës mes bashkëmoshatarëve. - Nxënësit ndahen në grupe pune dhe çdo grup cakton një drejtues të tij. - Grupi diskuton dhe hedh idetë fillestare mbi format që mund të marrë produkti dhe për çfarë rubrikash mund të ketë nevojë materiali mbështetës.	
2	Përcaktimi i rubrikave të udhëzuesit dhe ndarja e punës në grupe.	- Diskutim i përbashkët për të përcaktuar përmbajtjen e udhëzuesit, bazuar në nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara, nxënësve të sapoardhur ose në vështirësi përfshirjeje. - Mësuesi sjell shembuj praktikë dhe udhëzon klasën për mënyrën e formulimit të rubrikave që do të përfshihen (si të ndihmojmë në lexim, si të jemi mikpritës, si të përfshijmë në lojë).	- Nxënësit, në grupe, krijojnë një skicë paraprake për rubrikën që do të punojnë (në fletë ose platformë digjitale – sipas moshës, mundësive dhe pajisjeve në shkollë). - Nxënësit sjellin ide, skema ose materiale ndihmëse (vizatime, emoji, fjali të thjeshta mbështetëse), që do të diskutohen dhe përfshihen në versionin final.





		- Ndarja e klasës në grupe pune: çdo grup merr përsipër një rubrikë specifike të udhëzuesit. Diskutojnë dhe planifikojnë se çfarë përmbajtjeje do të përgatisin. - Fillon puna për mbledhjen e ideve dhe organizimin e materialit në grup.	
3-4	Puna në grupe për përgatitjen e rubrikave të udhëzuesit.	- Çdo grup punon në përgatitjen e përmbajtjes për rubrikën që ka marrë përsipër, duke pasur si qëllim të krijojë materiale të qarta, mbështetëse dhe të përshtatshme për bashkëmoshatarët në nevojë. - Mësuesi ndihmon grupet me pyetje të tilla, si: ✓ Si mund ta shpjegojmë një rregull me fjalë të thjeshta? ✓ Si t'i japim ndihmë një shoku pa e vendosur në siklet? ✓ Si mund ta bëjmë një tekst të kuptueshëm	- Nxënësit përgatisin në shtëpi një draft paraprak të përmbajtjes së rubrikës së tyre (p.sh., një faqe me këshilla, një tabelë me emoji ose një skemë të thjeshtë veprimi). - Përgatiten për ta paraqitur në klasë për koment dhe përmirësim.





		edhe me ndihmën e ilustrimeve? - Nxënësit punojnë me tabela të thjeshta, emoji, fjali të shkurtra, vizatime ose forma vizuale që i bëjnë mesazhet më të qarta. - Diskutim dhe komentim në grup për idetë dhe materialet e përgatitura, për të ruajtur koherencën dhe qëllimin mbështetës të udhëzuesit.	
5-6	Bashkërendimi i përmbajtjes dhe organizimi i udhëzuesit në një strukturë të përbashkët.	- Nxënësit diskutojnë dhe përcaktojnë renditjen e rubrikave, mënyrën e paraqitjes së tyre dhe pamjen e përgjithshme të udhëzuesit (faqosje, dizajn, titujt, simbolet e përsëritshme që krijojnë unitet vizual). - Mësuesi ndihmon në sigurimin e një strukture të thjeshtë dhe koherente, ku të gjitha zërat e grupeve të përfshihen pa përsëritje dhe në mënyrë të kuptueshme për lexuesit. - Diskutim mbi formën përfundimtare të	- Çdo grup sjell versionin e përmirësuar të rubrikës së vet, të dakordësuar nga grupi dhe të përgatitur për ta përfshirë në udhëzues. - Grupi i koordinimit (një përfaqësues nga secili grup) përgatit një draft të të gjithë udhëzuesit (fizik dhe/ose digjital) për t'u rishikuar dhe finalizuar në orën e ardhshme.





		produktit: në çfarë material do të printohet udhëzuesi? Si do të duket versioni digjital? - Një grup nxënësish të talentuar në teknologji dhe në arte ndihmojnë në përgatitjen vizuale dhe teknike të udhëzuesit.	
6	Finalizimi i përmbajtjes dhe organizimi i produktit përfundimtar.	Secili grup përfundon rubrikën që ka përgatitur për udhëzuesin e klasës “Të gjithë për njëri-tjetrin”. Mësuesi ndihmon në përmirësimin e formulimeve, qartësimin e mesazheve dhe përzgjedhjen e ilustrimeve apo të elementeve pamore (emoji, skema, simbole etj.). Klasës i paraqitet modeli i strukturës përmbledhëse (faqosja, renditja e rubrikave etj.) dhe merren vendimet përfundimtare për bashkimin e materialeve në një version të përbashkët fizik dhe/ose digjital.	Çdo grup përgatit një version të redaktuar të rubrikës së vet, i cili do të bashkohet me kontributet e grupeve të tjera. Në fund të orës, përfaqësues të grupeve lexojnë përmbajtjen që kanë përgatitur dhe marrin komente nga të tjerët për përmirësim përpara prezantimit përfundimtar.
7	Përgatitja për prezantimin e udhëzuesit në klasë.	- Mësuesi u rikujton nxënësve qëllimin e produktit/ udhëzuesit dhe rëndësinë e komunikimit të	- Çdo grup përgatit një fletë të shkurtër për të ndarë me klasën:





		qartë dhe të kuptueshëm për bashkëmoshatarët. - Çdo grup punon për të strukturuar paraqitjen e rubrikës që ka përgatitur: si do ta prezantojnë, cilat pjesë do lexohen, cilat ilustrime do të tregohen dhe çfarë do të shpjegojnë. - Mësuesi ndihmon në menaxhimin e kohës dhe bën pyetje udhëzuese për të nxitur mendimin kritik dhe vetëvlerësimin.	✓ Mesazhin kryesor të rubrikës. ✓ Një shembull konkret nga përmbajtja. ✓ Si mendon se kjo rubrikë mund të ndihmojë dikë në nevojë?
8-9	Prezantimi i produktit përfundimtar - "Të gjithë për njëri-tjetrin".	- Çdo grup prezanton rubrikën që ka hartuar, duke shpjeguar: ✓ përmbajtjen, ✓ ilustrimet e përdorura (emoji, simbole, vizatime), ✓ mënyrën si rubrika e tyre ndihmon në përfshirjen e një bashkëmoshatare në nevojë. - Mësuesi lehtëson një diskutim të hapur pas çdo prezantimi, duke nxitur reagime pozitive, pyetje	Çdo nxënës plotëson një fletë reflektimi individual ku përshkruan: - Çfarë ka mësuar nga projekti? - Si e ndihmon ky produkt dikë në klasë ose në shkollë? - Si e sheh veten në rolin e një mbështetësi të bashkëmoshatarëve në të ardhmen?





		dhe komente nga bashkëmoshatarët. - Pasi prezantimet përfundojnë, udhëzuesi final vendoset në një hapësirë të dukshme të klasës ose të shkollës dhe, nëse ka mundësi, ndahet edhe në version digjital përmes medias së përzgjedhur.	
--	--	--	--

Përshkrimi i produktit të projektit:

“Të gjithë për njëri-tjetrin” është një udhëzues praktik, i krijuar nga nxënësit e klasës së shtatë, për të ndihmuar në gjithëpërfshirjen sociale, emocionale dhe mësimore të nxënësve që përballen me vështirësi në klasë ose në shkollë. Ky produkt është rezultat i punës në grup, reflektimit, integritit ndërlëndor dhe përmban rubrika konkrete me këshilla të thjeshta, mesazhe mbështetëse dhe udhëzime të zbatueshme në situata të jetës së përditshme në shkollë.

Udhëzuesi është strukturuar në disa pjesë që trajtojnë tema si: mikpritja e nxënësve të rinj në shkollë, ndihma në lexim dhe në mësim, përfshirja në lojë dhe në pushime, komunikimi i sjellshëm, mbështetja emocionale, si dhe fjalët dhe shprehjet që nxisin gjithëpërfshirjen. Të gjitha përmbajtjet përgatiten duke përdorur gjuhë të thjeshtë, emoji, skema dhe ilustrime që ndihmojnë në kuptimin dhe përdorimin e tyre nga të gjithë nxënësit.

Udhëzuesi ka dy versione:

- fizik, i vendosur në klasë ose në shkollë, në një vend të dukshëm për përdorim të përditshëm.
- digjital, i shpërndarë në platformën ose në rrjetet e komunikimit të shkollës, për të pasur qasje të lehtë dhe të vazhdueshme.





Ky produkt synon të jetë mjet mbështetës dhe që përforcon kulturën e gjithëpërfshirjes, barazisë dhe solidaritetit në klasë, duke e kthyer çdo nxënës në një “aktor” të rëndësishëm për ndërtimin e një mjedisi miqësor për të gjithë.

Struktura e udhëzuesit “Të gjithë për njëri-tjetrin”

1. Hyrje

- Qëllimi i udhëzuesit.
- Për kë është ky udhëzues?
- Si mund të përdoret në klasë dhe në shkollë?

2. Si mund të jemi mikpritës dhe gjithëpërfshirës?

- Fjalët e para që bëjnë diferencën.
- Si ta ndihmojmë një nxënës të ri në klasë ose në shkollë?
- Shembuj konkretë mikpritjeje dhe sjelljeje gjithëpërfshirëse.

3. Si të ndihmojmë një nxënës me nevoja të veçanta në lexim dhe gjatë gjithë procesit mësimor?

- Sugjerime për t’u ulur bashkë dhe për të lexuar me radhë.
- Si ta sqarojmë një detyrë pa e bërë tjetrin të ndihet keq?
- Përdorimi i ilustrimeve dhe i fjalëve të thjeshta.

4. Si të përfshijmë dikë në lojë dhe gjatë kohës së pushimit?

- Lojëra që i përfshijnë të gjithë.
- Si ta ftojmë dhe të përfshijmë dikë që rri vetëm?
- Rregulla të lojërave që janë të sigurta për të gjithë.

5. Si të flasim me fjalë pozitive dhe të mbështesim të tjerët emocionalisht?

- Fjalë inkurajuese që mund të përdorim.
- Si të dëgjojmë pa gjykuar?
- Si të dallojmë dhe të ndihmojmë në rastet kur dikush është i shqetësuar?

6. Çfarë të mos harrojmë në klasë?

- Si të mos e marrim ndihmën si diçka të vogël dhe pa vlerë?
- Si të kujdesemi për njëri-tjetrin pa dallime?
- Si të kërkojmë ndihmë kur nuk dimë si të veprojmë?

7. Simbolet ndihmëse dhe faqet vizuale

- Emoji dhe tabela që mund të përdoren në klasë.





- Simbolet që tregojnë mbështetje, bashkëpunim dhe mirëkuptim.
- Vizatime dhe fletë informuese të thjeshta për çdo situatë.

8. *Burime të dobishme*

- Kujt mund t'i drejtohesh nëse sheh që dikush nuk ndihet mirë?
- Rregullorja e klasës / shkollës për gjithëpërfshirjen.
- Platforma dhe materiale mbështetëse.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi i nxënësve në këtë projekt bazohet në parimet e vlerësimit për të nxënë dhe të vlerësimit të të nxënës, duke u përqendruar te procesi i të nxënës, angazhimi personal dhe kontributi në punën e grupit. Qëllimi nuk është vetëm vënia e notës, por rritja e ndërgjegjësimit dhe e përgjegjësisë sociale.

Përveç vlerësimit të procesit dhe të produktit të projektit nga mësuesi, mund të përdoren edhe vlerësime të tjera, si:

- *Vlerësimi brenda grupit (ndërmjet nxënësve):* Nxënësit vlerësojnë mënyrën se si e kanë ndihmuar, dëgjuar dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin.
- *Vetëvlerësimi:* Çdo nxënës plotëson një fletë vetëvlerësimi ku reflekton mbi:
 - ✓ Rolin që ka pasur në projekt.
 - ✓ Aftësitë që ka zhvilluar (komunikim, bashkëpunim, shkrim udhëzues etj.).
 - ✓ Çfarë do të përmirësonte herës tjetër?
 - ✓ Ndjenjat që ka përjetuar gjatë projektit dhe çfarë ka mësuar mbi gjithëpërfshirjen.

Reflektimi mbi projektin:

Në përfundim të projektit, zhvillohet një *seancë reflektimi në klasë*, ku nxënësit:

- ndajnë përvojën e tyre personale gjatë zhvillimit të udhëzuesit.
- diskutojnë për ndikimin që mund të ketë udhëzuesi në jetën e përditshme të shkollës.
- japin mendime për mënyrën se si mund të përmirësohet më tej klima e gjithëpërfshirjes në klasë dhe në shkollë.





10.3. Model projekti për klasën e tetë

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: VIII

Tema e projektit: Nga fjala në vepër: *E gjelbra jonë nis këtu*

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi:

- harton tekste joletrare (njoftim, plan pune, udhëzim ose raport) për organizimin dhe dokumentimin e një veprimtarie konkrete në mbrojtje të mjedisit.
- përdor gjuhë të qartë dhe të përshtatshme për të përshkruar veprimtarinë nga planifikimi deri në zbatim.
- dokumenton ndryshimin e bërë në mjedis përmes krahasimeve para/pas dhe përshkrimeve me shkrim.
- përdor mjete digjitale për të përgatitur produktin përfundimtar të projektit.
- merr pjesë në mënyrë aktive në një veprimtari konkrete në mbrojtje të mjedisit përreth shkollës.
- reflekton dhe vlerëson kontributin e përbashkët dhe personal në realizimin e projektit.

Konceptet kryesore:

- Llojet e teksteve joletrare (njoftimi, udhëzimi, plani i punës, raporti), qëllimi dhe struktura e tyre.
- Gjuha e teksteve joletrare: përdorimi i foljeve në formë veprorë, lidhëzave, fjalive të llojeve të ndryshme.
- Kohezioni dhe koherenca në tekste: renditja e ideve, lidhja mes pjesëve të tekstit dhe organizimi në paragrafë/njësi të kuptueshme.
- Dokumentimi me shkrim dhe vizualizimi i ndryshimit: përshkrimi i mjedisit para/pas veprimtarisë, përdorimi i termave për krahasim dhe progres.
- Mjete digjitale për të planifikuar, ndjekur dhe dokumentuar procesin e një veprimi konkret në grup, duke hartuar materiale të integruara (tekst, imazh, grafikë) dhe duke ndarë produktin përfundimtar në një platformë të përshtatshme prezantimi.

Kohëzgjatja e projektit / orët mësimore: 11 orë mësimore:





- 5 orë në klasë: për diskutimin, planifikimin, hartimin e teksteve joletrare dhe përgatitjen e materialeve.
- 4 orë në terren: për realizimin e veprimtarive konkrete në mjedisin brenda ose përreth shkollës (pastrim, mbjellje, vendosje table, sistemim hapësire etj.), përfshirë mbledhjen e të dhënave dhe dokumentimin vizual.
- 2 orë për prezantimin dhe reflektimin: nxënësit paraqesin rezultatet, analizojnë ndryshimin dhe reflektojnë për përvojën e tyre personale dhe në grup.

Partnerët:

- Mësuesi i biologjisë ndihmon në identifikimin e problematikave mjedisore reale në mjedisin përreth shkollës dhe jep këshilla për ndërhyrje të përshtatshme (p.sh., çfarë bime mund të mbillet, çfarë materiali është i sigurt për përdorim).
- Mësuesi i qytetarisë ndihmon nxënësit të kuptojnë rolin e tyre si qytetarë aktivë dhe të organizojnë veprimtari si një nismë të përbashkët shkollore.
- Mësuesi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet nxënësit në përdorimin e mjeteve digjitale për hartimin e planit të punës, dokumentimin e procesit dhe përgatitjen e produktit përfundimtar.
- Stafi drejtues i shkollës bashkëpunon për lehtësimin e logjistikës dhe sigurisë gjatë veprimtarive në mjediset e jashtme të shkollës.
- Prindër ose kujdestarë mund të kontribuojnë me ndihmë fizike, mjete pune ose mbështetje për transportin e materialeve të nevojshme gjatë zbatimit të veprimtarive praktike.
- Përfaqësues të bashkisë / njësisë administrative mund të ofrojnë mbështetje ose leje për ndërhyrjen në një hapësirë publike afër shkollës, nëse është e nevojshme.
- Organizata mjedisore / komunitare (nëse janë të pranishme) mund të japin ide, mjete ose mbështetje teknike për realizimin e veprimtarive me ndikim konkret në mjedis.

Veprimtaritë kryesore:

- Vëzhgim dhe identifikim i një problemi real mjedisor në territorin përreth shkollës (zonë e ndotur, kënd i braktisur, hapësirë pa gjelbërim, mur i dëmtuar etj.).





- Diskutim në klasë mbi rëndësinë e ndërhyrjes, përcaktim i qëllimit të projektit dhe llojit të veprimtarisë që do të ndërmerret nga nxënësit (p.sh.: pastrim, mbjellje, sistemim, rregullim, ndërtim simbolik, vendosje table informuese etj.).
- Ndarja e nxënësve në grupe pune sipas roleve të nevojshme: grupi i logistikës, grupi i shkrimit, grupi i dokumentimit digjital etj..
- Hartimi i materialeve funksionale: njoftimi i brendshëm për nxënësit, udhëzimi për realizimin e veprimtarisë, plani i punës me detyra dhe afate, raporti përfundimtar.
- Mbledhja dhe përgatitja e materialeve të nevojshme për realizimin e ndërhyrjes në natyrë (mjetet e pastrimit, bimët, dheu, kontejnerë të ricikluar, vegla të tjera pune, tabela për komunikim etj.).
- Zbatimi i veprimtarive konkrete në terren: pastrimi i një pjese të shkollës (p.sh., në kuadër të nismës “Toka në shkollë” mbillen pemë ose lule në kopshtin e shkollës), mbjellje, ndërtim i një kutie për riciklim ose i një këndi të gjelbër, sistemim me gurë ose materiale të riciklueshme, vendosje e një table me tekst të shkurtër, udhëzues për ruajtjen e mjedisit.



- Dokumentimi i procesit përmes fotografive, përshkrimeve të shkruara dhe përgatitjes së një materiali përfundimtar që përmbledh: si ka qenë përpara / pas, qëllimin, hapat dhe ndikimin e ndërhyrjes.
- Përdorimi i mjeteve digjitale për organizimin, dokumentimin dhe prezantimin e projektit, në funksion të bashkëpunimit në grup dhe të komunikimit të produktit final, si p.sh.:
 - ✓ Google Docs për hartimin e teksteve joletrare.





- ✓ *Trello* për ndarjen e roleve, planifikimin e detyrave dhe ndjekjen e afateve në grup.
 - ✓ *Canva* për krijimin e materialeve pamore (postera, infografikë, tabela para/pas).
 - ✓ *Padlet* për mbledhjen e fotove, përshkrimeve dhe komenteve gjatë procesit.
 - ✓ *Google Slides* ose *Book Creator* për ndërtimin e prezantimit përfundimtar multimedial.
 - ✓ *Google Forms* për mbledhjen e vlerësimeve ose reflektimeve pas projektit.
 - ✓ *iMovie* / *Clipchamp* (opsionale) për përgatitjen e një videoje të shkurtër dokumentuese.
- Prezantimi i projektit në klasë ose në një kënd të shkollës, përmes leximit të teksteve, shfaqjes së fotove dhe ndarjes së përvojës me të tjerët.
 - Reflektim mbi përvojën e realizuar: vlerësim i kontributit personal dhe të grupit, diskutim mbi rëndësinë e veprimtarive konkrete dhe mundësitë për veprimtari të tjera në të ardhmen.

Burimet kryesore të informacionit:

- Vëzhgime direkte mbi mjedisin përreth shkollës (fotografi, shënime, përshkrime të zonave me problematika mjedisore).
- Informacione nga mësuesi i biologjisë mbi ndikimet mjedisore dhe llojet e ndërhyrjeve të lehta që mund të realizohen në shkollë.
- Udhëzime teknike nga mësuesi i qytetarisë për organizimin e punës në grup dhe ndarjen e roleve në veprime kolektive të përbashkëta.
- Modele të teksteve joletrare (njoftime, plane pune, udhëzime, raporte), të përzgjedhura nga mësuesi i gjuhës shqipe.
- Rregullore ose dokumente të tjera të shkollës ose të bashkisë që lidhen me përdorimin e hapësirave publike, mbjelljet ose pastrimet në mjedisin përreth.
- Platforma dhe burime digjitale të kontrolluara, si p.sh.:
 - ✓ <https://shkollatpermjedisin.al>
 - ✓ <https://greenline.al>
 - ✓ <https://ecocenter.al>





✓ <https://unicef.org/albania>

- Platforma dhe aplikacione për hartimin dhe për prezantimin e projektit, si p.sh.: Google Docs, Google Slides, Canva, Padlet, Book Creator, Trello, Genially.

Tematika e orëve të planifikuara:

Orët	Tema	Çfarë ndodh në klasë?	Puna e pavarur / Prezantimi i nxënësit
1	Identifikimi dhe shqyrtimi i problemit dhe i vendit të ndërhyrjes.	Diskutim mbi gjendjen e mjedisit përreth ose brenda shkollës. Përcaktimi i një problemi konkret që mund të zgjidhet nga nxënësit. Analizë e fotografive ose e kujtimeve nga lagjja/fshati.	Nxënësit vëzhgojnë mjedisin përreth dhe sjellin një fotografi apo përshkrim të një zone problematike.
2	Përcaktimi i qëllimit dhe planifikimi i veprimtarive.	Hartimi i qëllimit, detyrave, mjeteve dhe afateve për realizimin e ndërhyrjes. Ndarja në grupe dhe përcaktimi i detyrave për çdo grup.	Grupet përgatisin në Google Docs një draft të planit të punës.
3-4	Hartimi i teksteve joletrare.	Nxënësit shkruajnë njoftimin, planin e punës dhe udhëzimet për veprimtaritë që do të kryejnë. Nxënësit përqendrohen në qartësinë dhe funksionalitetin e tekstit.	Redaktim individual i teksteve për t'i përgatitur për prezantim.
5	Përdorimi i teknologjisë për dokumentim	Përdorimi i Google Slides, Canva, Padlet dhe Trello për organizimin e përmbajtjes dhe për përgatitjen e raportit përfundimtar.	Grupet mbledhin materiale (foto, tekste, grafika) për t'i përfshirë në prezantim.





	dhe bashkëpunim.		
6-8	Realizimi i veprimtarive në mjedis.	Nxënësit realizojnë veprimtaritë e planifikuara (pastrim, mbjellje, sistemim, vendosje objekti ose tabele). Çdo grup kujdeset për dokumentimin: mbledh foto dhe shënime gjatë procesit.	Përgatitja e përshkrimeve dhe e fotove për materialin përfundimtar.
9	Përgatitja e produktit përfundimtar.	Organizimi i materialeve (tekste, foto, tabela) dhe ndërtimi i prezantimit multimedial. Rishikimi dhe finalizimi nga klasa dhe të ftuarit (staf drejtues, mësues të shkollës, prindër/kujdestarë etj.).	Grupet dorëzojnë prezantimin përfundimtar dhe përgatiten për ta paraqitur.
10-11	Prezantimi dhe reflektimi.	Nxënësit paraqesin projektin për klasën ose për shkollën. Diskutim mbi arritjet, sfidat dhe ndikimin real të veprimit. Plotësim i fletës së reflektimit.	Nxënësit shkruajnë një reflektim personal mbi rolin e tyre dhe mësimet e nxjerra nga projekti.

Përshkrimi i produktit të projektit:

Produkti përfundimtar i projektit është një dokumentim multimedial i veprimtarive konkrete në mbrojtje të mjedisit përreth ose brenda shkollës, të ndërmarra dhe të realizuara nga vetë nxënësit. Ky produkt përfshin:

- Një prezantim digjital (në Google Slides, Book Creator, Padlet ose Genially), që përmbledh:
 - ✓ përshkrimin e problemit mjedisor të identifikuar nga nxënësit në bashkëpunim me mësuesit.





- ✓ planin e veprimtarive të hartuar nga nxënësit (njoftimi, udhëzimi, ndarja e roleve, afatet, personat përgjegjës etj.).
 - ✓ dokumentimin vizual të veprimtarive (foto para dhe pas ndërhyrjes, video të shkurta, përshkrime).
 - ✓ reflektimin e nxënësve për kontributin e tyre individual dhe të grupit.
 - ✓ sugjerime për vijimësinë ose përfshirjen e të tjerëve në veprimtari të ngjashme.
- Një zonë e transformuar në mjedisin brenda ose përreth shkollës (p.sh., një hapësirë e pastruar, një mur i sistemuar, një sipërfaqe e gjelbëruar me lule apo bimë), që mbart një ndryshim të dukshëm dhe të matshëm si rezultat i punës së nxënësve.
 - Një raport i shkruar, i hartuar nga nxënësit në bashkëpunim me mësuesin, ku përshkruhet procesi nga planifikimi deri te zbatimi, mësimet që nxorën, vështirësitë e hasura dhe efektet konkrete të ndërhyrjes.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi është i rëndësishëm dhe përfshin si procesin ashtu edhe produktin. Vlerësimi realizohet në tri forma/ lloje: vlerësim për të nxënë, vlerësim i të nxënit dhe vetëvlerësim/reflektim.

Vlerësimi për të nxënë (formues, gjatë procesit):

Ky lloj vlerësimi realizohet në çdo fazë të projektit për të orientuar dhe për të përmirësuar punën e nxënësve:

- Angazhimi në diskutim dhe planifikim.
- Përdorimi i teksteve funksionale në mënyrë të qartë dhe të qëllimshme.
- Aftësia për të ndarë përgjegjësitë dhe për të bashkëpunuar në grup.
- Përdorimi i mjeteve digjitale në mënyrë të pavarur dhe efektive.
- Respektimi i afateve dhe udhëzimeve.

Vlerësimi i të nxënit (përmbledhës, me rubrikë vlerësimi):

Ky lloj vlerësimi realizohet në fund të projektit dhe përfshin kritere si p.sh.:

- Qartësia dhe funksionaliteti i teksteve joletrare (njoftim, plan, udhëzim, raport).
- Koherenca ndërmjet përshkrimit dhe veprimtarive konkrete.





- Dokumentimi i ndryshimit në mjedis (para/pas) me mjete dhe me forma të ndryshme (tekst, foto, video).
- Përdorimi i teknologjisë për hartimin dhe për prezantimin e produktit përfundimtar të projektit.
- Kreativiteti në zgjidhjen e problemit dhe angazhimi personal dhe në grup gjatë veprimtari të projektit.
- Bashkëpunimi dhe kontributi individual brenda grupit.
- Cilësia e prezantimit përfundimtar dhe përshtatja me audiencën.

Vetëvlerësimi dhe reflektimi i nxënësve

Çdo nxënës plotëson një fletë reflektimi me pyetje si:

- Çfarë mësova nga ky projekt për gjuhën, angazhimin, bashkëpunimin dhe mjedisin/ natyrën?
- Si kontribuova unë në grup dhe në të gjitha veprimtaritë përgjatë projektit?
- Çfarë më pëlqeu më shumë gjatë këtij projekti dhe pse?
- Cili ishte momenti më sfidues për mua?
- Si e shoh ndikimin real të punës sonë në mjedis?
- Çfarë do të bëja ndryshe në një projekt tjetër të ngjashëm?
- Si mund ta përdor këtë përvojë për të ndikuar pozitivisht edhe jashtë shkollës?

10.4. Modeli i projektit për klasën e nëntë

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: IX

Tema e projektit: Ne zgjedhim fjalën e mirë

Rezultatet e të nxënësve:

Nxënësi:

- hulumton dhe mbledh të dhëna përmes krijimit të një sondazhi online, analizon përgjigjet dhe nxjerr përfundime të mbështetura në të dhëna reale mbi ndikimin e gjuhës së përdorur nga të rinjtë në rrjete sociale.
- analizon dhe interpreton forma konkrete të ligjërimit digjital (komente, përshkrime, video, meme), duke dalluar strukturën, fjalorin dhe tonin e tyre, si dhe argumenton dallimin mes komunikimit brenda rregullave të etikës dhe gjuhës së urrejtjes.





- përdor në mënyrë të ndërgjegjshme dhe funksionale gjuhën shqipe në situata të ndryshme komunikimi (gojor dhe të shkruar), duke zgjedhur fjalë që nxisin bashkëpunimin, respektin dhe mirëkuptimin.
- krijon përmbajtje të personalizuar multimediale (poster, animacion i thjeshtë ose spot i shkurtër ndërgjegjësues), duke përdorur platforma si Canva Pro, Powtoon ose Animaker, për të transmetuar mesazhe pozitive që synojnë edukimin gjuhësor të bashkëmoshatarëve.
- strukturon dhe prezanton në mënyrë të qartë dhe tërheqëse produktin përfundimtar të projektit (mesazh, poster, video), përmes një prezantimi të drejtpërdrejtë ose të regjistruar me Prezi Video apo Genially, duke e përshtatur me audiencën dhe me qëllimin.
- argumenton në mënyrë kritike, me shembuj konkretë dhe referenca nga të dhënat, rëndësinë e përdorimit të gjuhës së mirë në jetën reale dhe digjitale, si dhe ndikimin që ka komunikimi i ndërgjegjshëm në ndërtimin e një mjedisi të sigurt.
- reflekton mbi përvojën personale gjatë zbatimit të projektit dhe propozom mënyra se si mund të përdorë të njëjtat aftësi gjuhësore dhe teknologjike në situata të tjera të jetës shkollore dhe shoqërore.

Konceptet kryesore:

- Sinonimia dhe antonimia
- Zgjedhja e fjalës në funksion të qëllimit
- Fjalori etik dhe fjalori diskriminues
- Gjuha standarde shqipe
- Regjistri gjuhësor
- Toni i ligjërimit dhe ndikimi i tij në marrëdhënie me të tjerët
- Etika e komunikimit në publik
- Komunikimi ndërpersonal dhe publik
- Ndërveprimi gjuhësor në mjedise digjitale
- Fjalë e thjeshtë dhe llojet e fjalëve të përbëra
- Lidhëzat në ndërtimin e tekstit
- Fjalitë pohore dhe fjalitë mohore
- Intonacioni dhe ndikimi në kuptim





- Koherenca në tekst
- Pasaktësia dhe paqartësia në komunikim
- Teksti argumentues
- Struktura e paragrafit argumentues (tezë, argument, shembull, përfundim)
- Tekstet digjitale (komente, mesazhe, përshkrime, meme etj.)
- Përdorimi i figurave letrare: ironia, hiperbola, metafora etj.
- Shmangiet nga gjuha standarde në ligjërimin joformal

Kohëzgjatja e projektit / orët mësimore: 10 orë mësimore

Partnerët:

- Mësuesi i qytetarisë, i cili mbështet nxënësit për trajtimin e temave që lidhen me etikën në komunikim dhe të drejtat e njeriut.
- Mësuesi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), i cili ndihmon nxënësit në përdorimin e mjeteve digjitale për realizimin e posterave, videove apo prezantimeve ndërvepruese.
- Psikologu shkollor, i cili mbështet diskutimin rreth ndikimit emocional të gjuhës, bullizmit verbal dhe ndërtimit të marrëdhënieve të shëndetshme në klasë dhe online.
- Stafi drejtues i shkollës, i cili mbështet organizimin e prezantimit publik, ekspozitës në mjediset e shkollës dhe përfshirjen e komunitetit.
- Prindër / anëtarë të këshillit të prindërve, si dëgjues në prezantimin përfundimtar ose si pjesëmarrës në vlerësimin e produktit.
- Një organizatë vendore ose kombëtare për të drejtat e fëmijëve / të rinjve.

Veprimtaritë kryesore:

- Diskutim në klasë mbi ndikimin që kanë fjalët në marrëdhëniet ndërpersonale dhe në komunikimin online. Nxënësit ndajnë përvoja të jetuara ose të dëguara.
- Analizë gjuhësore e fragmenteve të shkruara nga rrjete sociale, komente, mesazhe digjitale (të zgjedhura dhe të anonimizuara), për të dalluar regjistrin gjuhësor, tonin, qëllimin dhe ndikimin e fjalëve të përdorura.





- Planifikimi i një sondazhi online (në Mentimetër ose Google Forms) për të mbledhur të dhëna mbi mënyrën si e perceptojnë bashkëmoshatarët përdorimin e gjuhës në komunikimin digjital.
- Analiza dhe interpretimi i të dhënave nga sondazhi: përzgjedhja e përgjigjeve për t'u cituar dhe ndërtimi i grafikëve dhe përfundimeve nga nxënësit.
- Përpunimi i mesazhit dhe hartimi i një teksti argumentues që mbështet përdorimin e gjuhës në mënyrë etike dhe kundërshton gjuhën përjashtuese ose fyese.
- Krijimi i produktit final: realizimi në grup i një materiali ndërgjegjësues si poster digjital, animacion, video-mesazh ose prezentim ndërveprues, duke përdorur platforma, si: Canva, Genially, Powtoon, Prezi Video.
- Organizimi i një prezantimi publik në klasë ose në një aktivitet të hapur, ku nxënësit prezantojnë produktet përfundimtare dhe komunikojnë përvojën e tyre me të tjerët (prindër, mësues, bashkëmoshatarë).
- Reflektim individual dhe në grup mbi mënyrën si ndryshon qëndrimi ynë ndaj gjuhës përmes ndërgjegjësimit dhe analizës. Nxënësit shkruajnë një tekst të shkurtër reflektues mbi atë që kanë mësuar dhe si do ta përdorin në të ardhmen.

Burimet kryesore të informacionit:

- Tekste shkollore të gjuhës shqipe (klasa 9)
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet mbi lirinë e shprehjes dhe të drejtën e dinjitetit njerëzor), si referencë për të diskutuar kufijtë e fjalës së lirë dhe përgjegjësinë gjuhësore.
- Rregullorja e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.
- Kodi i etikës në komunikim si dhe materiale të përpunuara nga mësuesi mbi sjelljen e pranueshme në mjediset online dhe në mjediset publike.
- Pyetësori i krijuar nga vetë nxënësit, si burim parësor i të dhënave për analizë, reflektim dhe ndërtim të përfundimeve.
- Uebfaqe dhe platforma edukative shqiptare që trajtojnë temën e etikës në komunikim, si p.sh.:
 - ✓ www.isigurt.al





- ✓ www.crca.al
- ✓ www.unicef.org/albania
- Artikuj dhe përmbajtje autentike nga rrjetet sociale (të përzgjedhura nga mësuesi), për analizë gjuhësore dhe diskutim mbi ndikimin emocional të gjuhës në mjediset digjitale.
- Platforma për krijimin e produkteve digjitale edukative, si:
 - ✓ Canva për krijimin e posterëve dhe materialeve pamore ndërgjegjëse
 - ✓ Genially / Prezi Video për prezantime interaktive
 - ✓ Powtoon për realizimin e videove të thjeshta dhe mesazheve kreative
 - ✓ Mentimeter / Microsoft Forms / Google Forms për krijimin dhe analizën e sondazheve

Tematika e orëve të planifikuara:

Orët	Tema	Çfarë ndodh në klasë?	Puna e pavarur / Prezantimi i nxënësit
1	Hyrje në temën e projektit dhe vetëdijësimi për ndikimet që ka gjuha.	Diskutim mbi fuqinë e fjalës në jetën reale dhe në internet. Analizë e një situatë ose fragmenti nga rrjetet sociale. Përcaktimi i qëllimit të projektit.	Nxënësit sjellin një koment, situatë ose përvojë reale që ilustron përdorimin pozitiv ose negativ të gjuhës.
2	Ndërtimi i pyetësorit.	Diskutim mbi pyetjet që mund të zgjerojnë të kuptuarit e temës. Udhëzime për ndërtimin e një sondazhi etik dhe funksional. Ndarja në grupe.	Çdo grup harton një pyetësor digjital në Forms/Mentimeter dhe e shpërndan për mbledhjen e të dhënave.
3	Analiza dhe interpretimi i të dhënave.	Nxënësit lexojnë dhe diskutojnë përgjigjet e sondazhit. Identifikojnë modele dhe probleme të	Grupet përgatisin një skicë me përfundime dhe citojnë disa përgjigje për t'i përfshirë në produktin përfundimtar.





		përsëritura. Fillojnë të nxjerrin përfundime.	
4	Ndërtimi i mesazhit: Teksti argumentues dhe struktura e tij.	Udhëzime për shkrimin e një mesazhi ndërgjegjësues dhe etik. Përdorimi i toneve dhe fjalëve përfshirëse. Modelim dhe ushtrim i tekstit argumentues.	Nxënësit hartojnë një tekst të shkurtër bindës (slogan, fjalim, mesazh) që do të përdoret në poster ose video.
5	Përdorimi i teknologjisë për ndërtimin e produktit të projektit.	Prezantim i mjeteve si Canva, Genially, Prezi Video, Poëtoon. Diskutim mbi formatin vizual dhe ndikimin e pamjes në përçimin e mesazhit.	Grupet nisin ndërtimin e produktit përfundimtar duke përdorur mjetet digjitale të përzgjedhura.
6-7	Zhvillimi dhe finalizimi i materialit multimedial.	Grupet përpunojnë tekstin, përzgjedhin imazhet dhe përgatitin pamjen përfundimtare. Mësuesi jep udhëzime për qartësinë gjuhësore dhe vizuale.	Grupet përfundojnë postera digjitale, video ose prezantime ndërvepruese dhe i dorëzojnë për rishikim.
8-9	Prezantimi i projektit në klasë ose edhe për komunitetin.	Çdo grup prezanton produktin përpara klasës dhe të ftuarve (mësues, drejtues, prindër). Diskutim mbi përvojën dhe mesazhin.	Nxënësit mbajnë fjalën e prezantimit, tregojnë zgjedhjet gjuhësore dhe teknologjike, si dhe reagojnë ndaj pyetjeve.
10	Reflektimi dhe mbyllja.	Diskutim i përbashkët mbi ndikimin e fjalës dhe rolin e nxënësve në përmirësimin e komunikimit. Përmbyllje e projektit.	Nxënësit plotësojnë një fletë reflektimi individual dhe vlerësojnë kontributin e grupit dhe produktin final.





Përshkrimi i produktit të projektit:

Produkti përfundimtar i projektit është një material ndërgjegjësues multimedial (i krijuar nga nxënësit në grupe), që synon të promovojë përdorimin etik të gjuhës në mjediset digjitale dhe shoqërore. Ky material do të përqendrohet në mesazhin “Ne zgjedhim fjalën e mirë”, dhe do të ndërtohet mbi të dhëna reale të mbledhura nga sondazhi i kryer prej nxënësve.

Forma që mund të marrë produkti, në varësi të zgjedhjes së grupit:

- *Poster digjital ndërgjegjësues*, i realizuar në platforma si *Canva* ose *Genially*, me tekst të shkurtër argumentues, imazhe të përzgjedhura dhe citime nga të dhënat e pyetësorit.
- *Video e shkurtër* (3-5 minuta), e përgatitur me *Powtoon* ose *Prezi Video*, ku nxënësit lexojnë një tekst të krijuar prej tyre ose paraqesin situata problematike dhe mënyra për të komunikuar ndryshe.

Të gjitha produktet do të përmbajnë:

- Një mesazh të qartë dhe brenda rregullave të etikës.
- Gjuhë të përzgjedhur, duke shmangur fjalët nxitëse apo përjashtuese.
- Strukturë të rregullt të tekstit (hyrje, ide kryesore, thirrje për veprim).
- Dëshmi nga sondazhi, për të treguar përfshirjen e komunitetit të nxënësve.
- Elementë vizualë dhe teknikë të menduar që e bëjnë mesazhin tërheqës dhe të kuptueshëm për publikun.



Produktet do të prezantohen në klasë ose në një veprimtari të hapur me pjesëmarrjen e mësuesve, drejtuesve të shkollës dhe prindërve, si dhe do të publikohen në mjedise të dukshme të shkollës (mur, faqe zyrtare, kanal komunikimi online i shkollës etj.).

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Vlerësimi i nxënësve në këtë projekt përfshin:





- *Vlerësim formues (gjatë procesit):*
 - ✓ Vëzhgimi i angazhimit të nxënësve në diskutime, analiza dhe punën në grup.
 - ✓ Ndjekja e saktësisë gjuhësore në ndërtimin e teksteve argumentuese.
 - ✓ Përmirësimi gjatë ndërtimit të produktit multimedial.

- *Vlerësim përfundimtar:*

Realizohet nëpërmjet një rubrike vlerësimi, që përfshin disa kritere (shihni rubrikën e vlerësimit të projektit).

- *Vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët*
 - ✓ Nxënësit plotësojnë një fletë vetëvlerësimi, ku reflektojnë për angazhimin e tyre, rolin në grup dhe mësimet që kanë marrë.
 - ✓ Çdo nxënës vlerëson grupin tjetër përmes një fletëthyesi të thjeshtë me kritere të qarta.

Reflektimi përfundimtar

Pas përfundimit të prezantimeve, zhvillohet një diskutim, ku nxënësit ndajnë:

- Çfarë mësuam mbi gjuhën dhe ndikimin e saj?
- Si e përjetuan bashkëpunimin në grup?
- Si do të ndryshojnë mënyrën e komunikimit në të ardhmen?

10.5. Modeli projekti për klasën e dhjetë

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: X

Tema e projektit: Shkolla e së ardhmes

Rezultatet e të nxënës:

Nxënësi:

- identifikon një sfidë konkrete të shkollës, përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave nga komuniteti shkollor.
- harton një propozim të strukturuar qartë (hyrje, përshkrim i gjendjes, ide zgjidhjeje, përfitime të mundshme, përmbyllje), duke përdorur gjuhë të saktë, stil të qartë dhe ton zyrtar, të përshtatshëm për komunikim me stafin drejtues të shkollës ose me institucione të tjera arsimore.
- shkruan dhe redakton lloje të ndryshme tekstesh joletrare (njoftim, kërkesë, përmbledhje, poster-informativ, email, përshkrim dokumentues, tekst





argumentues), duke demonstruar zotërim të tipareve të tyre gjuhësore dhe përmbajtjesore.

- dokumenton procesin e projektit përmes një ditari digjital, duke përdorur gjuhë rrëfyese dhe përshkruese, si dhe koment reflektues mbi veprimtaritë e realizuara, vendimet e marra dhe rezultatet e arritura, me qëllim vlerësimin e progresit personal dhe të grupit të tij.
- përdor elementë gjuhësorë për të patur ndikim tek audienca, përmes zgjedhjes së tonit, stilit dhe fjalorit sipas qëllimit të komunikimit.
- prezanton në mënyrë bindëse idenë për ndryshim përpara një audience reale (drejtoria e shkollës, këshilli i mësuesve, qeveria e nxënësve, bordi i shkollës etj.), duke përdorur mjete digjitale (Genially, Prezi, Google Slides) dhe duke përshtatur gjuhën me audiencën dhe kontekstin.
- reflekton për procesin, për përfitimet reale dhe për pengesat e hasura, si dhe propozon mënyra për zbatim të qëndrueshëm të ndryshimit ose për përshtatjen e tij në kontekste të tjera.

Konceptet kryesore:

- Struktura funksionale e një kërkesë zyrtare / njoftimi (titulli, përshëndetja, qëllimi, arsyetimi, propozimi, mbyllja, nënshkrimi).
- Komunikimi institucional: fjalor objektiv dhe korrekt, ton neutral, shmangie e emocioneve, saktësi dhe qartësi.
- Kohezioni logjik në ndërtimin e tekstit: përdorimi i lidhëzave për lidhjen e ideve dhe ndërtimi i fjalive të përbëra.
- Përdorimi i regjistrit të përshtatshëm gjuhësor sipas qëllimit, kontekstit dhe audiencës.
- Tekstet jolettrare.
- Gjuha e saktë në ndërtimin e projekt propozimit: përdorimi i kohës së ardhme, renditja logjike e veprimeve, konkretësia e përshkrimit etj.
- Organizimi i prezantimit multimedial në aspektin gjuhësor: ndërtimi i slide-ve përmes titujve, fjali të shkurtra, thirrjes për veprim.

Kohëzgjatja e projektit / orët mësimore: 8 orë





Partnerët:

- Mësuesi i gjuhës shqipe që koordinon projektin, udhëzon në ndërtimin e teksteve joletrare (njoftime, kërkesa, përshkrime, analiza, reflektime), ndihmon në qartësinë dhe korrektësinë gjuhësore.
- Mësuesi i TIK-ut që mbështet për ndërtimin e ditarit digjital, prezantimit multimedial (në platforma si Google Slides, Canva, Genially, Prezi), si dhe për përpunimin e materialeve dokumentuese (foto, video, tabela, grafikë).
- Stafi drejtues i shkollës, mësuesi kujdestar, këshilli i mësuesve.
- Qeveria e nxënësve që ndihmon në mbledhjen e të dhënave dhe identifikimin e sfidës reale.
- Prindër ose përfaqësues të komunitetit (opsional), si bashkëbisedues për të mbledhur mendime, për të ofruar mbështetje ose për të dëshmuar impaktin e ndryshimit.

Veprimtaritë kryesore:

- *Diskutim mbi përvoja në shkollë:* Nxënësit ndajnë përvoja pozitive dhe sfiduese në mjedisin shkollor, identifikojnë aspekte që ndikojnë në mirëqenie, përfshirje, motivim dhe zhvillim të tyre.
- *Mbledhje e të dhënave nga shkolla:* Përmes pyetësorëve, bisedave me nxënës të tjerë, ose vëzhgimeve, nxënësit përcaktojnë problemet reale që ndikojnë në jetën e përditshme në shkollë.
- *Zgjedhja e ideve konkrete për ndryshim:* P.sh.: “Shkëmbim njohurish” pa mësues: një orë në javë, nxënësit mësojnë nga njëri-tjetri tema që i zgjedhin vetë (podcast, IA, grafiti, kodim); Klasë pa karrige, e cila është një klasë që për 2 javë funksionon me tavolina fleksibël, ulëse në dysheme etj.; shkolla si qytet digjital që nënkupton krijimin e një harte digjitale të shkollës me QR code në vende kyç: biblioteka, zyra e psikologut, mjediset sportive etj., që të japin informacion, mesazhe inkurajuese ose udhëzime për mirëqenie etj.
- *Hartimi i propozimit për ndryshim:* Çdo grup pune shkruan një dokument për drejtuesit, ku përfshin përshkrimin e sfidës, analizën, idenë për ndryshim, përfitimet dhe mënyrën e zbatimit.





- *Simulimi / testimi për 1–2 javë i ndryshimit*: Zbatimi në shkallë të vogël i ndryshimit të propozuar për të vlerësuar ndikimin në komunitetin shkollor. Dokumentim i procesit me foto, përshkrime, vëzhgime.
- *Mbajtja e një ditari digjital të projektit*: Nxënësit përshkruajnë çfarë ndodh gjatë fazave të projektit, reflektojnë mbi përvojat, bashkëpunimin, sukseset dhe sfidat.
- *Përgatitja e prezantimit përfundimtar*: Grupi ndërton një raport multimedial “Para dhe pas”, ku përfshihen foto, tabela, përshkrime, video dhe komente reflektuese.
- *Prezantimi i projektit përpara klasës dhe të ftuarve të tjerë*: Nxënësit paraqesin idenë dhe ndikimin e saj përpara stafit drejtues, mësuesve dhe/ose qeverisë së nxënësve dhe bordit të shkollës.
- *Dizajnimi i një fushate mbështetëse*: Përdorimi i mjeteve si posterë, kartolina, video, sondazhe apo peticione për të mbështetur zbatimin e plotë të ndryshimit të propozuar.

Burimet kryesore të informacionit:

- Pyetësorët dhe intervistat me nxënës, mësues, prindër dhe drejtues për të identifikuar sfida, pritshmëri dhe ide për përmirësime në shkollë.
- Dokumente zyrtare të shkollës, si plani afatmesëm i shkollës, planet vjetore, për të kuptuar çfarë është parashikuar tashmë dhe ku mund të veprohet.
- Raporte dhe studime mbi të ardhmen e arsimit si vizionet e UNESCO-s, OECD-së ose MAS-it për shkollën e së ardhmes, teknologjinë në arsim, mirëqenien në shkollë etj.
- Uebfaqet e shkollave model në vende të tjera për të krahasuar dhe marrë ide konkrete që mund të përshtaten në kontekstin lokal.
- Artikuj informues dhe video edukative mbi teknologjinë në arsim, arkitekturën shkollore, psikologjinë e të nxënësve dhe komunitetin mësimor.
- Burimet personale të nxënësve si kujtime, përvoja, ide të dala nga vëzhgimi i përditshëm, të cilat pasurojnë projektin me ndjeshmëri personale dhe realitet konkret.
- Seriale, filma dhe animacione që trajtojnë arsimin e së ardhmes për të nxitur imagjinatën rreth teknologjisë, bashkëpunimit ndërkulturor dhe mjedisit shkollor





Tematika e orëve të planifikuara:

Orët	Tema	Çfarë ndodh në klasë?	Puna e pavarur / Prezantimi i nxënësit
1	Diskutim dhe vendimmarrje e përbashkët për temën e projektit. Ndarja e grupeve.	Diskutim mbi konceptin e “Shkolla e së ardhmes”. Shembuj ndërkombëtarë dhe ide nga nxënësit. Mësuesi lehtëson procesin e zgjedhjes së temës specifike për çdo grup (p.sh. teknologjia në mësim, hapësira të gjelbra, orari fleksibël, mirëqenia emocionale, gjithëpërfshirja në shkollë etj.).	Çdo grup vendos temën e vet dhe krijon një pyetje udhëheqëse. Fillon të mendojë për ndarjen e roleve.
2	Planifikimi i projektit dhe ndarja e detyrave.	Në grup: përcaktohen përgjegjësit për hulumtim, për hartimin e propozimit, për përgatitjen e prezantimit etj. Diskutim mbi burimet që do përdoren.	Nxënësit organizojnë detyrat në një tabelë plani dhe hapin skedarin e ditarit digjital për grupin.
3	Hulumtimi dhe mbledhja e informacionit.	Udhëzime për burime të besueshme dhe format e mbledhjes së informacionit (intervistë, vërtetim, pyetësor, vëzhgim etj.).	Grupet mbledhin të dhëna nga komuniteti shkollor për të mbështetur idenë e tyre.
4	Hartimi i propozimit institucional.	Mësuesi prezanton strukturën e një kërkesë/propozimi për drejtuesit e shkollës ose për një institucion përgjegjës për arsimin. Diskutim mbi stilin dhe tonin formal.	Nxënësit hartojnë një kërkesë ose propozim të strukturuar për drejtuesit e shkollës ose për një institucion përgjegjës për arsimin.





5	Hartimi i ditarit digjital dhe simulimi i prezantimit.	Diskutim mbi rëndësinë e reflektimit. Udhëzime për ndërtimin e një “portofoli digjital”. Simulim i prezantimit në klasë, me komente dhe sugjerime.	Nxënësit shkruajnë hyrjen/reflektimin e parë në ditarin digjital dhe korrigjojnë pjesët e prezantimit.
6-7	Prezantimi i projektit.	Prezantim formal i çdo grupi para klasës dhe një audience të zgjeruar (drejtues, mësues, këshilli i nxënësve, etj.).	Çdo grup paraqet idenë e vet për “Shkolla e së ardhmes” përmes mjeteve digjitale (Canva, Prezi, etj.) dhe dorëzon propozimin me shkrim.
8	Reflektimi mbi procesin dhe hapat për zbatimin real të ideve.	Diskutim për ecurinë e projektit, pengesat dhe sukseset. <i>Cilët do të jenë hapat e mëtejshëm për zbatimin real të ideve?</i>	Nxënësit plotësojnë reflektimin përfundimtar në ditar, vlerësojnë kontributin e grupit dhe japin sugjerime për përmirësim të mëtejshëm.

Çfarë është ditari digjital?

Ditari digjital është një dokument personal interaktiv ku nxënësi pasqyron në mënyrë të vazhdueshme përvojat, veprimet, vështirësitë dhe arritjet gjatë zhvillimit të projektit. Ai shërben si një mjet vetëvlerësimi dhe reflektimi, por gjithashtu dokumenton ecurinë reale të punës së kryer individualisht apo në grup.

Qëllimet e ditarit digjital janë:

- Të ndihmojë nxënësin të ndërjegjësohet për rolin dhe kontributin e tij në projekt.
- Të nxisë vetëreflektimin dhe mendimin kritik mbi vendimet e marra, komunikimin me grupin dhe rezultatet e arritura.
- Të dokumentojë të gjithë procesin e të nxënës, jo vetëm produktin përfundimtar të projektit.

Struktura e ditarit digjital është si më poshtë:





Pjesa hyrëse:

- Pritshmëritë personale për projektin.
- Roli që nxënësi dëshiron të marrë në grup.
- Sfidat që nxënësi parashikon.

Reflektimi javor / pas çdo ore:

- Çfarë u bë sot?
- Çfarë funksionoi mirë?
- Ku hasëm në vështirësi?
- Çfarë do të bëja ndryshe?
- Si ndihmova dhe si më ndihmuan të tjerët?

Analiza përfundimtare:

- Çfarë mësova nga ky projekt?
- Si ndryshuan mendimet ose qëndrimet e mia?
- Si mund ta përdor këtë përvojë në të ardhmen?

Elementë pamorë / digjitalë (opsionale):

- Foto nga puna në grup
- Screenshots nga puna online (Forms, Canva etj.)

Si realizohet dhe ku mbahet?

- Si dokument në Word me ndarje në ditë/tema
- Si prezantim Google Slides me nga një slide për çdo reflektim
- Si video ditar (vlog) i shkurtër (p.sh., në Flipgrid)

Rekomandohet të ruhet në Google Drive ose në një platformë që mësuesi e ndjek (Google Classroom, Padlet etj.)

Përshkrimi i produktit të projektit:

Produkti i projektit është një propozim i argumentuar dhe i dokumentuar për një ndryshim konkret në shkollë, i formuluar nga nxënësit mbi bazën e një ideje reale, të mbështetur në të dhëna dhe përvojë praktike. Ky produkt përfaqëson vizionin e nxënësve për shkollën që duan në të ardhmen dhe synon të krijojë ndikim real në institucion. Ai përfshin përshkrimin e sfidës, zgjidhjen e propozuar, simulimin e





zbatimit dhe reflektimin mbi rezultatet, të përmbledhura në një material të unifikuar dhe të komunikueshëm me nxënësit, mësuesit, stafin drejtues etj.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

- Vlerësim formues gjatë gjithë procesit, nëpërmjet udhëzimeve, ndihmës së drejtpërdrejtë dhe komenteve dhe sugjerimeve të mësuesit.
- Vlerësim përmbledhës i produktit final (propozimi formal), bazuar në kritere të qarta.
- Reflektimi i nxënësve:

Nxënësit plotësojnë në mënyrë individuale ditarin digjital, duke u ndalur në:

- ✓ Çfarë kanë mësuar për veten dhe për grupin?
- ✓ Çfarë funksionoi mirë dhe çfarë do të përmirësonin?
- ✓ Çfarë ndikimi pati projekti te ta dhe te komuniteti i shkollës?

Ditari digjital shërben si bazë për vetëvlerësim dhe reflektim metakognitiv, i cili vlerësohet jo për opinionet e dhëna, por për thellësinë e mendimit dhe qartësinë e shprehjes.

10.6. Model projekti për klasën e dhjetë

Lënda: Letërsi

Klasa: X

Tema e projektit: Folklori rilind në fjalët tona

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi:

- analizon veçoritë gjuhësore dhe tematike të folklorit shqiptar, duke identifikuar motive, personazhe dhe mesazhe në krijime të ndryshme popullore.
- krijon një tekst letrar origjinal të frymëzuar nga folklori, në bashkëpunim me grupin, duke përdorur elemente të të shkruarit krijues dhe gjuhë të figurshme.
- zbaton njohuritë drejtshkrimore, leksikore dhe stilistike, duke redaktuar dhe duke përpunuar krijimin e vet dhe të grupit.
- përdor mjete digjitale për të ndihmuar në përgatitjen, formatimin dhe paraqitjen e produktit përfundimtar në një libërth elektronik.





- reflekton mbi lidhjen mes folklorit dhe shprehjes personale, duke parë trashëgiminë kulturore si burim frymëzimi për të ndërtuar një zë të vetin bashkëkohor.

Konceptet kryesore:

- Motivi letrar
- Tipologjia e personazheve në letërsinë gojore (heroikë, simbolikë, kolektivë)
- Mesazhi dhe universalja në folklor
- Struktura e tekstit poetik dhe tekstit tregimtar
- Rrëfimtari dhe këndvështrimi
- Figurat stilistike (krahasimi, metafora, personifikimi, hiperbola etj.)
- Stili dhe toni në të shkruar
- Fjalori i pasur dhe shprehjet frazeologjike popullore
- Redaktimi gjuhësor dhe rregullat drejtshkrimore
- Formatimi i tekstit në mjete digjitale

Kohëzgjatja e projektit / orët mësimore: 7 orë

Partnerët:

- Mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë, i cili udhëheq procesin e analizës së folklorit dhe mbështet krijimin dhe redaktimin e teksteve.
- Mësuesi i TIK-ut, i cili ndihmon në përgatitjen e produktit final si libërth elektronik dhe në përdorimin e mjeteve digjitale.
- Mësuesi i artit, i cili mbështet ilustrimin e teksteve dhe krijimin e elementeve vizuale për produktin përfundimtar.
- Mësuesi i bibliotekës së shkollës, i cili ofron tekste folklorike referuese, mbështet në hulumtimin dhe përzgjedhjen e materialeve.
- Prindër / anëtarë të komunitetit (gjyshër, të afërm etj.), të cilë ndajnë rrëfime, këngë, shprehje popullore që mund të frymëzojnë krijimet e nxënësve.

Veprimtaritë kryesore:

Zhvillim njohurish mbi folklorin shqiptar





Nëpërmjet leximit të eposit, përrallave, këngëve dhe legjendave popullore, nxënësit njihen me tiparet gjuhësore, tematike dhe figurative të folklorit shqiptar; me motivet dhe personazhet si dhe me vlerat artistike dhe historike që mbartin.

Zgjedhja e një motivi ose e një figure frymëzuese

Çdo grup përzgjedh një motiv, situatë apo figurë popullore për ta ripërpunuar në formë letrare moderne, duke ndërtuar lidhjen midis trashëgimisë gojore dhe zërit të tyre bashkëkohor.

Krijimi dhe redaktimi i tekstit original

Grupi harton një tekst letrar original të frymëzuar nga folklori, si: tregim, monolog, poezi e ose tekst rrëfyes, si dhe e redakton atë duke zbatuar njohuritë gjuhësore dhe stilistike.

Ilustrimi dhe pasurimi vizual i përmbajtjes

Grupi realizon vizatime, kolazhe ose elemente të tjera pamore që pasqyrojnë botën e tyre të krijuar, duke thelluar kuptimin e tekstit dhe fuqizuar ndikimin estetik.

Dizajnimi i libërthit elektronik me mjetet e teknologjisë

Nxënësit përgatisin produktin final si libërth elektronik, duke përdorur platforma të thjeshta dhe kreative për organizimin dhe paraqitjen e përmbajtjes.

Prezantimi i produktit në një ngjarje publike në shkollë

Libërthi elektronik prezantohet në një orë të hapur për komunitetin shkollor, si dëshmi e krijimtarisë së nxënësve dhe pasqyrim i trashëgimisë gojore të ripërtërirë.

Burimet kryesore të informacionit:

- Teksti shkollor i letërsisë për klasën e dhjetë, për kapitujt kushtuar folklorit shqiptar.
- Përmbledhje folklorike shqiptare (këngë epike, legjenda, përralla popullore etj.), në format fizik ose digjital, për të hulumtuar motivet e trashëgimisë gojore shqiptare.
- Platforma digjitale për krijimin e libërthit: Canva.com, Book Creator, Google Slides / PowerPoint për dizajnimin dhe prezantimin e produktit përfundimtar.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, fjalorë të gjuhës shqipe, atlas dialektogjik online (fjalori.shkenca.org.) etj., për zbatimin e rregullave drejtshkrimore dhe pasurimin leksikor gjatë shkrimit dhe redaktimit.





- Materiale ndihmëse për të shkruar në mënyrë krijuese.

Tematika e orëve të planifikuara:

Orët	Tema	Çfarë ndodh në klasë?	Puna e pavarur / Prezantimi i nxënësit
1	Njohja me projektin dhe hulumtimi i folklorit.	Mësuesi bashkëbisedon me nxënësit për të vendosur për temën, rezultatet dhe produktin final të projektit. Fillon diskutimi mbi veçoritë e folklorit shqiptar dhe ndarja e punës në grupe.	Grupi shqyrton tekste folklorike (këngë legjendare, përralla, këngë historike etj.), dhe përzgjedh një motiv ose figurë që do ta ripërpunojë.
2	Analiza e krijimeve popullore folklorike.	Analizohen në klasë motivet letrare, personazhet, mesazhet dhe simbolika në tekstet e përzgjedhura.	Çdo grup konkretizon konceptin e tekstit krijues që do të zhvillojë.
3	Hartimi i tekstit letrar krijues.	Udhëzime për të shkruar një tekst të frymëzuar nga folklori. Diskutim mbi gjuhën e figurshme dhe strukturën e tekstit letrar.	Nxënësit hartojnë në grup versionin e parë të tekstit. Ata fillojnë përmirësimin dhe redaktimin e mes anëtarëve të grupit të punës.
4	Redaktimi dhe rishikimi.	Analizë drejtshkrimore dhe stilistike e tekstit. Sugjerime për përmirësim nga mësuesi dhe nga nxënësit e tjerë.	Grupi përpunon dhe përfundon tekstet e redaktuara dhe nis mbledhjen e elementeve vizuale për libërthin.
5	Formatimi digjital i libërthit.	Prezantim i platformave digjitale për krijimin e librit (Canva, Book Creator).	Nxënësit punojnë në kompjuter për të krijuar libërthin elektronik, të





		Udhëzime teknike për formatimin.	gjitha grupet, me tekstet dhe ilustrimet.
6-7	Prezantimi i produktit përfundimtar.	Grupet prezantojnë punën e tyre në një orë letrare ose prezantim të hapur për komunitetin e shkollës.	Diskutim dhe reflektim mbi procesin, përvojën krijuese dhe lidhjen mes folklorit dhe jetës së tyre.

Përshkrimi i produktit të projektit:

Produkti përfundimtar i projektit është një libërth elektronik me krijime letrare origjinale të nxënësve, të frymëzuara nga folklori shqiptar dhe të përpunuara në mënyrë bashkëkohore.

Çdo grup harton disa tekste letrare (tregime, poezi, monologë etj.) që mbështeten në motive, personazhe dhe elemente të tjera të folklorit shqiptar, të rimenduara në kontekstin e sotëm dhe të realizuara me mjete të gjuhës së figurshme dhe të shkrimit krijues.

Të gjitha krijimet redaktohen, ilustrohen dhe përfshihen në një libërth digjital me titull, strukturë të rregullt dhe dizajn të kujdesshëm. Ky libërth mund të përgatitet duke përdorur platforma si *Canva* ose *Book Creator* dhe publikohet në format PDF.

Libërthi synon të përdoret nga nxënësit e tjerë si model për punë krijuese, të lexueshme dhe frymëzuese, si dhe të shërbejë për promovimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet gjuhës së të rinjve.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Lloji i vlerësimit	Përshkrimi
Vlerësim formues	Mësuesi ndjek procesin e krijimit, bashkëpunimit në grup dhe zbatimin e njohurive letrare gjatë gjithë projektit, duke dhënë udhëzime të vazhdueshme dhe komente për përmirësim.
Vlerësim përfundimtar i produktit të projektit	Vlerësohet cilësia e libërthit përfundimtar: koherenca e përmbajtjes, pasuria gjuhësore dhe stilistike, korrektësia drejtshkrimore, kreativiteti dhe përfshirja e





	elementeve folklorike në mënyrë origjinale dhe të kuptimtë.
Vetëvlerësim	Çdo grup vetëvlerëson kontributin e vet, vështirësitë e hasura dhe aftësitë e zhvilluara gjatë procesit.
Vlerësim i nxënësve për njëri-tjetrin	Nxënësit japin komente dhe vlerësime mbi krijimet e grupeve të tjera, duke u përqendruar te origjinaliteti, përdorimi i gjuhës së figurshme dhe mesazhi i tekstit.
Reflektim i përbashkët	Në përmbyllje të projektit, zhvillohet një bashkëbisedim, ku mësuesi dhe nxënësit ndajnë mendimet mbi vlerat e folklorit, rolin e tij si frymëzim dhe përvojën e të shkruarit krijues në grup.

10.7. Modeli i projektit për klasën e njëmbëdhjetë

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: XI

Tema e projektit: Zëri ynë në qytet

Rezultatet e të nxënësve:

Nxënësi:

- analizon dhe përpunon informacion nga burime të ndryshme (intervista, pyetësorë, artikuj, dokumente zyrtare), duke përdorur strategji të të lexuarit për qëllime kërkimore dhe funksionale.
- harton një raport qytetar, të strukturuar sipas modelit të EU Youth Dialogue, me rekomandime konkrete për institucionet vendore.
- shkruan tekste të ndryshme joletrare, si e-mail formal, njoftime publike, artikuj argumentues për nisma komunitare, në përputhje me qëllimin, audiencën dhe kontekstin.
- përdor fjalor të pasur, duke dalluar regjistrin informal nga ai formal, si dhe duke shmangur gabimet drejtshkrimore, gramatikore dhe të stilit.
- ndërton dhe strukturon një prezantim multimedial, duke organizuar tekstin në tituj, nëntituj dhe elemente logjike (shkak, pasojë, zgjidhje etj.), dhe duke e përshtatur për komunikim publik.





- prezanton në mënyrë të qartë dhe të bindshme gjetjet dhe rekomandimet e projektit para një audience të gjerë, duke respektuar rregullat e komunikimit verbal dhe joverbal.
- bashkëpunon me grupin për ndarjen e roleve, analizën e rezultateve dhe përfaqësimin e ideve në mënyrë konstruktive.
- reflekton mbi rolin e tij si qytetar aktiv, duke analizuar efektin e ndërhyrjes së grupit dhe sfidat e hasura gjatë procesit të zbatimit të projektit.

Konceptet kryesore:

- *Tekstet joletrare:* raporti, artikulli opinion, letra e hapur, komunikata për shtyp, postimi publik: qëllimi, struktura dhe stili i tyre në kontekst publik.
- *Teksti argumentues:* ndërtimi i tezës, arsyetimi logjik, përdorimi i fakteve dhe shembujve për të bindur një audiencë institucionale apo shoqërore.
- *Gjuha e komunikimit formal dhe publik:* përdorimi i toneve neutrale, fjalorit të saktë, strukturave të qarta dhe shmangia e emocioneve apo gjuhës së përditshme.
- *Struktura e një raporti qytetar sipas modelit EU Youth Dialogue:* përmbledhja ekzekutive, përshkrimi i problemit, analiza e të dhënave, rekomandimet, ndërlidhja logjike e pjesëve.
- *Multimodaliteti në komunikim:* ndërtimi i mesazhit për publikun përmes fjalës së shkruar, imazheve, grafikëve dhe prezantimit digjital.
- *Fjalori dhe shprehjet e përfshira në diskutimin qytetar dhe institucional:* përkufizimi dhe përdorimi i nocioneve si “pjesëmarrje rinore”, “akses publik”, “politika vendore”, “qytetari aktive” etj.
- *Vëzhgimi dhe përshkrimi gjuhësor i realitetit:* si përshkruhet një situatë sociale me saktësi dhe qartësi për t’u adresuar në mënyrë institucionale.

Kohëzgjatja e projektit / orët mësimore: 8 orë mësimore

Partnerët: Duke qenë një projekt angazhues, numri i bashkëpunëtorëve është i zgjeruar, si:

- Mësuesi i gjuhës shqipe (udhëheqësi i projektit), i cili mbështet nxënësit në përgatitjen e raporteve, teksteve, argumentimeve dhe prezantimeve.





- Mësuesi i qytetarisë ndihmon në kuptimin e rolit të qytetarit aktiv dhe institucioneve vendore.
- Mësuesi i TIK-ut, i cili mbështet në krijimin e prezantimit multimedial dhe përpunimin e të dhënave nga pyetësorët.
- Përfaqësues të Bashkisë / Njesisë Administrative për të dëgjuar prezantimin dhe për t'u konsultuar mbi propozimet e nxënësve.
- Aktivistë lokalë / organizata rinore mund të ndihmojnë nxënësit për të kuptuar procesin e vendimmarrjes lokale dhe për t'i përfshirë në aksione konkrete.
- Gazetarë / media lokale mund të japin sugjerime për hartimin e komunikimeve në media dhe të ndihmojnë në publikimin e mesazhit të projektit.

Veprimtaritë kryesore:

Zgjedhja e temës dhe planifikimi i projektit

Nxënësit diskutojnë çështjet më të ndjeshme që prekin fëmijët dhe të rinjtë në komunitet. Nëpërmjet votimit, klasa vendos për një problem konkret për të cilin do të hartohet raporti qytetar⁶ dhe do të ndërmerret një aktivitet konkret (aksion).

Kërkimi dhe mbledhja e informacionit

Përdoren intervista me të rinj dhe aktorë lokalë, pyetësorë online dhe burime informacioni (artikuj, raporte vendore, portale) për të analizuar përmasat e problemit.

Përpunimi dhe interpretimi i të dhënave

Të dhënat e mbledhura analizohen në mënyrë kritike: nxënësit identifikojnë tendenca, shqetësime të përsëritura dhe boshllëqe institucionale. Këto gjetje strukturohen në raportin qytetar sipas modelit të EU Youth Dialogue.⁷

⁶ Qëllimi i raportit qytetar është të pasqyrojë në mënyrë të qartë një çështje që prek fëmijët dhe të rinjtë në komunitetin lokal (p.sh., mungesa e hapësirave kulturore, siguria rrugore, shërbimet sociale), të mbështetur mbi të dhëna dhe opinione të mbledhura nga vetë nxënësit, dhe të paraqesë rekomandime të realizueshme për institucionet vendore (bashki, njësi administrative etj.).

⁷[EU Youth Conference Report and Implementation Toolbox - National Youth Council of Ireland](#)





Modeli i EU Youth Dialogue është një qasje e Bashkimit Evropian që synon të përfshijë të rinjtë në proceset e vendimmarrjes përmes dialogut të strukturuar ndërmjet tyre dhe institucioneve publike. Ky model përdoret për të mbledhur mendimet, shqetësimet dhe propozimet e të rinjve,

për t'i kthyer ato në rekomandime të strukturuar, që më pas u dorëzohen institucioneve përkatëse vendimmarrëse në nivel vendor apo kombëtar.

Struktura e një raporti qytetar sipas modelit të EU Youth Dialogue përfshin rubrikat e mëposhtme:

- Titulli dhe përmbledhja ekzekutive
- Identifikimi i problemit
- Metodologjia
- Analiza e të dhënave dhe e gjetjeve
- Rekomandimet konkrete për institucionet
- Shtojca dhe referencat

Ndërtimi i produktit përfundimtar

Nxënësit hartojnë raportin qytetar të shoqëruar me një produkt multimedial (prezantim, fletëpalosje, video, infografikë etj.). Në tekstin e raportit përfshihen rekomandime konkrete dhe të zbatueshme.

Zhvillimi i një veprimtarie konkrete në komunitet

Grupi organizon një nismë të drejtpërdrejtë me impakt lokal, si p.sh. ngritja e një muri idesh për të rinjtë, testimi publik i një aplikacioni për raportimin e shqetësimeve të tyre, një forum rinor me aktorë lokalë, ose krijimi i një hapësire fizike simbolike për zërin e tyre (kuti sugjerimesh, instalacion në qendër komunitare etj.).

Prezantimi publik dhe advokimi

Produkti dhe rekomandimet u prezantohen përfaqësuesve të Bashkisë/Njesisë administrative në një ngjarje publike ose tryezë të hapur, ku nxënësit argumentojnë zgjidhjet e propozuara dhe ftojnë institucionet për bashkëpunim.



Burimet kryesore të informacionit:

- Intervistat me të rinj dhe qytetarë të komunitetit lokal për të kuptuar në mënyrë të drejtpërdrejtë problemin e identifikuar dhe ndikimin e tij në jetën e përditshme të të rinjve.
- Pyetësorë të krijuar nga nxënësit (Google Forms) që përdoren për të mbledhur të dhëna statistikore dhe opinione të strukturuar nga bashkëmoshatarët dhe grupet e interesit.
- Faqet zyrtare të Bashkive, Njësi Administrative dhe institucioneve publike për të shqyrtuar planet vendore të zhvillimit, programet për të rinjtë, raportet e monitorimit dhe dokumentet e politikave publike.
- Modeli i raportit qytetar sipas EU Youth Dialogue si udhëzues për strukturimin profesional të dokumentit me rekomandime.
- Media lokale dhe portale për të analizuar trajtimin e problemit në opinionin publik dhe për të ndërtuar argumente të mbështetura në fakte.
- Tekstet shkollore për strukturat e teksteve joletrare.

Tematika e orëve të planifikuara:

Orët	Tema	Çfarë ndodh në klasë?	Puna e pavarur / Prezantimi i nxënësit
1	Zgjedhja e temës së projektit dhe ndarja e roleve.	Mësuesi bashkëbisedon me nxënësit për të identifikuar çështje që prekin të rinjtë në komunitetin e tyre. Nxënësit ndahen në grupe, zgjedhin një temë konkrete dhe formulojnë pyetjen kyç.	Çdo grup përcakton rolet, planifikon hapat e parë, harton një plan veprimi.
2	Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave.	Diskutim mbi burimet e informacionit dhe metodologjitë: intervista,	Zhvillohen intervista, shpërndahen pyetësorë, analizohen dokumente





		pyetësorë, vrojtime, analiza dokumentesh. Udhëzime për përdorimin e gjuhës.	zyrtare, artikuj, ligje, statistika etj.
3	Përpunimi i të dhënave dhe hartimi i raportit.	Analizë e të dhënave të mbledhura. Diskutim mbi strukturën e raportit qytetar sipas modelit të EU Youth Dialogue. Përcaktimi i rekomandimeve.	Grupet hartojnë raportin qytetar me analizën e problemit dhe propozimet konkrete.
4	Ndërtimi i teksteve funksionale dhe përgatitja për komunikimin publik.	Udhëzime për hartimin e teksteve si: email formal, njoftim publik, letër e hapur, komunikim për shtyp/ media. Përshtatja e përmbajtjes për audiencën.	Nxënësit përgatisin tekstet e nevojshme për komunikim me institucionet dhe për fushatën ndërgjegjëse.
5	Ndërtimi i prezantimit multimedial dhe planifikimi i ndërhyrjes.	Planifikim i formës së komunikimit publik (slide, video, broshurë). Diskutim për formatin dhe skenarin e ndërhyrjes (aksionit qytetar) që do të realizohet.	Punohet në dizajnin vizual dhe përmbajtjen e prezantimit. Hartohet skenari për ndërhyrjen konkrete.
6-7	Realizimi i prezantimit dhe i ndërhyrjes.	Grupet paraqesin projektin para klasës, drejtuesve të shkollës ose një audience më të gjerë. Zbatohet ndërhyrja konkrete (p.sh., takim publik, kënd informues, nismë pilot etj.).	Të gjithë anëtarët kontribuojnë në prezantim dhe në realizimin e aktivitetit.





8	Vlerësimi përfundimtar dhe përgatitja për dorëzim.	Diskutim për vlerësimin sipas kritereve të përcaktuara.	Dorëzohet raporti qytetar dhe materialet shoqëruese.
---	--	---	--

Përshkrimi i produktit të projektit:

Produkti përfundimtar i projektit është një paketë e integruar që përfshin:

- Raport qytetar të strukturuar sipas modelit të EU Youth Dialogue,
- Prezantim publik multimedial,
- Një ndërhyrje konkrete (aksion qytetar) në komunitetin shkollor ose lokal.

Raporti qytetar përmban:

- Përkufizimin e qartë të problemit që prek të rinjtë në komunitet, të mbështetur me të dhëna të mbledhura përmes pyetësorëve, intervistave dhe vëzhgimeve.
- Analizën e përpunuar të këtyre të dhënave, me interpretim dhe argumentim nga vetë nxënësit.
- Rekomandime konkrete për institucionet vendore (bashkia, njësia administrative, zyra vendore arsimore etj.).
- Propozim për zgjidhje në përputhje me parimet e qytetarisë aktive dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Në shtojcë: modele tekstesh funksionale të shkruara nga nxënësit, si: letra e hapur, njoftim publik, e-mail formal, kërkesë institucionale etj.

Prezantimi publik:

- Një prezantim multimedial i ideuar për një audiencë të gjerë, me përdorimin e mjeteve si slide, video, infografikë ose broshurë, në përputhje me kriteret e komunikimit formal dhe publik.

Ndërhyrja konkrete (aksioni qytetar):

- Aktivitet i projektuar dhe i zbatuar nga nxënësit që u jep zë kërkesave të tyre për ndryshim. Mund të marrë formën e një debati publik me aktorë lokalë, një instalacion simbolik në mjediset shkollore ose pilotimi i një nisme konkrete në bashkëpunim me një institucion.





Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Për vlerësimin e nxënësve gjatë këtij projekti, mësuesi përdor:

- Vlerësimin formues (gjatë procesit)

Ky lloj vlerësimi ndihmon nxënësit të përmirësohen gjatë fazave të zhvillimit të projektit. Disa forma të këtij vlerësimi janë:

- ✓ Vëzhgimi i mësuesit gjatë diskutimeve në klasë dhe punës në grup.
- ✓ Pyetje orientuese për të nxitur të menduarin kritik (p.sh.: Si po e strukturojmë raportin? Si e mbështesim idenë me të dhëna?).
- ✓ Feedback i menjëhershëm për pjesët e para të raportit, tekstet joletrare, stilin dhe drejtshkrimin.
- ✓ Simulimet e prezantimit gjatë të cilave nxënësit provojnë paraqitjen publike dhe marrin sugjerime për përmirësim.

- Vlerësimin përfundimtar të produktit

Ky lloj vlerësimi përdoret në fund të projektit për të vlerësuar:

- ✓ Raportin qytetar: për strukturën, argumentimin, qartësinë, stilin dhe zgjidhjet konkrete.
- ✓ Tekstet joletrare (email, njoftim, artikull, letër e hapur): për qartësinë e qëllimit, strukturën, regjistrin, stilin dhe drejtshkrimin.
- ✓ Prezantimin publik: për mënyrën e të shprehurit, organizimin, përdorimin e mjeteve multimediale dhe aftësitë bindëse.

- Vlerësimin e nxënësve nga njëri-tjetri

Nxënësit mund të vlerësojnë grupin tjetër pas prezantimit (me kriterë të qarta dhe të përcaktuara paraprakisht), duke dhënë komente për qartësinë, ndikimin, argumentimin etj. Gjithashtu mund të vlerësojnë kontributin e anëtarëve të grupit të tyre.

- Vetëvlerësimin

Nxënësit mund të përgatisin një përmbledhje të kontributit të tyre:

- ✓ Cila ishte detyra ime kryesore në grup?
- ✓ Cili ishte kontributi im?
- ✓ Çfarë do të bëja ndryshe në një projekt tjetër?





10.8. Model projekti për klasën e dymbëdhjetë

Lënda: Gjuhë shqipe

Klasa: XII

Tema e projektit: Muzeu i shkollës sonë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi:

- përshkruan, organizon dhe paraqet materiale me karakter historik, kulturor dhe shoqëror që lidhen me jetën dhe kujtesën e shkollës, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit me shkrim dhe me gojë.
- planifikon dhe ndërton një produkt të përbashkët (muze fizik dhe/ose digjital) duke ndarë detyra, mbledhur burime, dhe dokumentuar punën e grupit.
- hulumton dhe përpunon informacion nga burime të ndryshme (intervista, dokumente, arkivë, kujtime, fotografi etj.), duke zbatuar teknika të kërkimit gjuhësor dhe dokumentar.
- përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për të krijuar forma të ndryshme të prezantimit të materialeve muzeale (galeri digjitale, etiketa për objekte, video rrëfime, aplikacione të thjeshta etj.).
- analizon dhe përzgjedh mënyra efektive komunikimi, si në aspektin gjuhësor, vizual dhe multimedial, për t'i bërë materialet muzeale të kuptueshme për një audiencë të gjerë.
- reflekton mbi rëndësinë e gjuhës, kujtesës dhe historisë lokale, dhe e paraqet këtë reflektim përmes produkteve të dokumentuara (etiketa muzeale, prezantime, përshkrime, rrëfime etj.).
- zhvillon aftësi bashkëpunimi dhe sipërmarrjeje, duke marrë pjesë aktive në ndarjen e roleve, mbledhjen e materialeve dhe ndërtimin final të muzeut.
- përgatit përmbajtje të strukturuar në forma të ndryshme: rrëfime, biografi të shkurtra, përshkrime objektesh, intervista, tituj ekspozitash, etj.

Konceptet kryesore:

- Teksti përshkrues
- Teksti rrëfyes





- Teksti informues-shpjegues
- Teksti argumentues
- Teksti udhëzues
- Teksti multimodal (tekst + figurë, audio, video)
- Fjalitë e përbëra nënrenditëse
- Përdorimi i kohëve të së shkuarës në rrëfimin objektiv
- Emrat dhe mbiemrat në tekstin/ paragrafin përshkrues (për cilësim objektsh dhe ngjarjesh)
- Sinonimet dhe antonimet në përshkrime
- Ndajfoljet si mjete për ngarkesë emocionale ose për theksim
- Lidhëzat për ndërtimin e kohezionit në tekst
- Shkronja e madhe për emërtimet gjeografike dhe të institucioneve
- Shkronja e madhe në tituj dhe nëntituj
- Përdorimi i shenjave të pikësimit
- Fjalori përshkrues dhe terminologjik (për objekte, dokumente, materiale, kujtime)
- Kuptimet e fjalëve
- Zgjedhja e fjalëve sipas stilit të tekstit
- Përdorimi i figurave stilistike
- Funksionet e gjuhës

Kohëzgjatja e projektit / orët mësimore: 8 orë mësimore

Partnerët:

- Nxënësit e klasave të tjera të shkollës për mbledhjen e kujtimeve, objekteve, ose rrëfimeve të gojës
- Këshilli i mësuesve për bashkëpunim në aspektin përmbajtësor dhe teknik (mbledhja e të dhënave, ilustrimi, digjitalizimi)
- Stafi drejtues i shkollës për akses në dokumente dhe materiale arkivore (dokumente, foto, regjistra, objekte etj.)
- Ish-mësues dhe ish-nxënës të shkollës si burim për intervista, dëshmi, foto, rrëfime personale që mund të përfshihen në muze





- Familjarë të nxënësve (gjyshër, prindër) si kontribues me objekte, histori personale apo përshkrime të së shkuarës së shkollës
- Zyra arsimore vendore ose biblioteka lokale për ekspozimin e përkohshëm të produktit ose mbështetje teknike/logjistike
- Specialistë të muzeologjisë ose arkivistë (nëse është e mundur në komunitet) për këshilla mbi mënyrën e ndërtimit të një ekspozite fizike apo digjitale

Veprimtaritë kryesore:



Shkolla jonë është një institucion i ri, me pak vite jetë. Nuk ka ende një histori të dokumentuar, as një vend ku të ruhen gjurmët e përbashkëta të kujtesës së saj. Megjithatë, çdo ditë që kalon lë pas kujtime, ngjarje, fytyra, objekte e përvoja që meritojnë të mbeten. Për këtë arsye, vendosëm të krijojmë muzeun e shkollës sonë: një hapësirë fizike dhe digjitale ku historia jonë të fillojë të shkruhet, të dëshmohet dhe të jetohet.

- *Prezantimi i idesë së projektit dhe diskutimi në klasë*
 - ✓ Bashkëbisedim mbi qëllimin e ngritjes së muzeut.
 - ✓ Pyetësor fillestar: Çfarë do të dëshironit të kishte një muze shkolle?
- *Përcaktimi i tematikave dhe i formave të përmbajtjes*
 - ✓ Zgjedhja e seksioneve të muzeut: “Viti i parë i shkollës”, “Zërat e së kaluarës”, “Shkolla dikur dhe sot” etj.
 - ✓ Vendosja e formave të shprehjes: përshkrime, rrëfime gojore, video, fotografi me legjenda etj.
- *Mbledhja e materialeve nga burime të ndryshme*
 - ✓ Intervistimi i ish-mësuesve, ish-nxënësve dhe e stafit drejtues.
 - ✓ Kërkime për objekte simbolike, fletore, regjistra të vjetër, fotografi, mjete mësimore të hershme.
 - ✓ Përzgjedhja e materialeve që do të përdoren.
- *Shkrimi dhe redaktimi i përmbajtjes muzeale*
 - ✓ Hartimi i teksteve përshkruese dhe rrëfyese për objektet dhe dëshmitë.





- ✓ Rishikim drejtshkrimor, leksikor dhe stilistik.
- ✓ Zgjedhja e titujve, nëntitujve dhe legjendave për çdo material.
- *Dizajnimi i materialeve për ekspozitë*
 - ✓ Përgatitja e përmbajtjes në formë të printuar (postera, kartela për objekte).
 - ✓ Krijimi i përmbajtjeve digjitale: audio-intervista, video-prezantime, infografikë.
- *Krijimi i ekspozitës muzeale në hapësirë fizike ose digjitale*
 - ✓ Organizimi i hapësirës së muzeut në mjedisin shkollor (klasë e përshtatur, korridor etj.).
 - ✓ Krijimi i një faqeje/blogu online nëse projekti ka edhe formë digjitale.
 - ✓ Vendosja e kodeve QR për përmbajtjet audio/video të krijuara nga nxënësit.
- *Hapja zyrtare e muzeut*
 - ✓ Ftesa për prindër, ish-mësues, përfaqësues të zyrës arsimore vendore dhe të bashkisë etj.
 - ✓ Prezantimi për komunitetin shkollor. Nxënësit prezantojnë pjesët e muzeut dhe procesin e punës.

Burimet kryesore të informacionit:

- Intervista dhe rrëfime nga ish-mësues, ish-nxënës, drejtues shkolle, staf ndihmës, prindër, gjyshër etj., të cilët sjellin dëshmi gojore dhe materiale me vlerë për historinë e shkollës.
- Dokumente arkivore të shkollës si p.sh.: regjistra të vjetër, fotografi zyrtare, dëftesa, plane vjetore të hershme, aktivitete të kaluara, diploma, shpallje, medalje, fletë-lajmërimë.
- Objekte simbolike të mbledhura nga komuniteti, si p.sh.: tekste dhe fletore të vjetra, mjete mësimore, uniforma, çanta, mjete pune nga laboratorë apo kabinete që do të shoqërohen me përshkrime dhe histori të shkruara.
- Tekste të krijuara nga nxënësit, si p.sh.: përshkrime, rrëfime, përsiatje, përmbledhje intervistash, përkufizime të shkruara sipas rregullave të gjuhës standarde.
- Tekste model për të ndihmuar në ndërtimin e gjuhës së përshkrimit, tekste joletrare si biografitë, përshkrimet muzeale, prezantimet dokumentare.





- Mjete TIK-u për mbledhje dhe përpunim informacioni, si p.sh.: Google Forms për intervista; Google Docs për bashkëpunim në shkrim; Padlet për grumbullim idesh; Canva për krijime vizuale; Audacity për regjistrim audio; platforma për krijimin e faqeve ose blogjeve etj.

Tematika e orëve të planifikuara:

Orët	Tema	Çfarë ndodh në klasë?	Puna e pavarur / Prezantimi i nxënësit
1	Pse na duhet një muze për shkollën tonë?	Diskutim mbi konceptin e muzeut shkollor, rëndësinë e kujtesës institucionale. Shqyrtim i disa modeleve inspiruese (video/foto).	Nxënësit shkruajnë një përsiatje të shkurtër personale: “Cila është gjurma që dua të mbetet nga shkolla ime?”
2	Cilat janë gjurmët e kujtesës së shkollës sonë?	Hartëzim i temave që do të mbulojë muzeu. Diskutim mbi llojet e materialeve dhe mënyrat e paraqitjes së tyre (tekste, audio, video, objekte).	Nxënësit zgjedhin temën ose këndvështrimin që do të përpunojnë individualisht ose në nën-grup.
3	Si i mbledhim të dhënat dhe si i intervistojmë individët që jetojnë?	Prezantim i pyetësorit model dhe o teknikave të intervistimit. Ushtrime me role për të praktikuar intervistat.	Nxënësit realizojnë intervistat me persona të përzgjedhur nga komuniteti shkollor ose lokal.
4	Si i përpunojmë dhe strukturojmë materialet?	Shqyrtim i materialeve të mbledhura. Klasifikimi tematik dhe gjuhësor i tyre. Udhëzime për ndërtimin e teksteve për muzeun.	Nxënësit përgatisin tekstet për objektet/rrëfimet që do të ekspozohen. Rishikim drejtshkrimor dhe stilistik i tyre.





5	Si e përcjellim kujtesën përmes fjalës dhe imazhit?	Punë krijuese me përshkrime, legjenda, tituj për objekte. Prezantim i mjeteve digjitale për dizajnimin e materialeve.	Nxënësit krijojnë posterat, skedarët informues dhe përmbajtjet multimediale (audio/video/infografikë).
6	Si e ndërtojmë muzeun tonë?	Organizim praktik i hapësirës: renditja e materialeve, vendosja e teksteve dhe elementeve vizuale. Testim teknik për përmbajtjet digjitale.	Nxënësit kontribuojnë në vendosjen e materialeve në mjedisin fizik ose në formatin digjital (faqe/blog/kod QR).
7-8	Hapja e muzeut dhe prezantimi para komunitetit.	Nxënësit prezantojnë seksionet e muzeut, rrëfejnë procesin e punës, shpjegojnë përmbajtjet dhe dëgjojnë reagimet e të ftuarve.	Muzeu hapet për komunitetin shkollor dhe lokal. Reflektim mbi ndikimin e projektit dhe ruajtjen e tij për vitet e ardhshme.

Përshkrimi i produktit të projektit:

Produkti përfundimtar i projektit është krijimi i një muzeu të shkollës, si një hapësirë



fizike dhe/ose digjitale që ruan, dokumenton dhe prezanton kujtesën institucionale të shkollës nga këndvështrimi i vetë nxënësve dhe i mësuesve. Muzeu do të përmbajë:

- Objekte të mbledhura nga komuniteti shkollor (mjete mësimore të vjetra, fotografi, fletore, uniforma, simbole etj.).





- Tekste informuese dhe përshkruese të hartuara nga nxënësit, bazuar në intervista, dëshmi gojore apo dokumente të vjetra.
- Materiale multimediale si audio-rrëfime, video, infografikë dhe përmbajtje të dizajnuara për ekspozim publik,
- Elemente interaktive nëse është e mundur, përmes kodeve QR ose blogut/faques online të muzeut.

Ky muze do të jetë një produkt i qëndrueshëm që mbetet në shkollë edhe pas përfundimit të projektit dhe mund të pasurohet vit pas viti nga brezat e ardhshëm të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi:

Lloji i vlerësimit	Përshkrimi
Vlerësim formues	Gjatë gjithë procesit të projektit, nxënësit marrin udhëzime, komente dhe pyetje nxitëse për të rishikuar dhe përmirësuar punën e tyre (tekste, intervista, përshkrime, elemente vizuale, prezantime). Mësuesi monitoron pjesëmarrjen në grup, respektimin e afateve dhe bashkëpunimin.
Vlerësim përfundimtar i produktit të projektit	Produkti final, muzeu i shkollës, vlerësohet në bazë të kriterëve të mëposhtme: cilësia e përmbajtjes, korrektësia gjuhësore, përzgjedhja e materialeve me vlerë, organizimi i informacionit, kreativiteti dhe përdorimi i TIK-ut. <i>(Shihni rubrikën e vlerësimit të projektit.)</i>
Vetëvlerësim	Nxënësit vlerësojnë kontributin e tyre individual, aftësitë e fituara (komunikim, bashkëpunim, përpunim gjuhësor, përdorim TIK-u), si dhe të grupit të tyre.
Vlerësim i nxënësve për njëri-tjetrin	Gjatë prezantimit të muzeut, nxënësit marrin reagime nga shokët e klasës dhe nga mësues të tjerë për ndikimin që ka muzeu dhe për mënyrën se si është përcjellë historia e shkollës.
Reflektim i përbashkët	Në fund të projektit, zhvillohet një diskutim reflektues në klasë mbi rëndësinë e dokumentimit të kujtesës, sfidat gjatë procesit dhe mënyrat për ta mbajtur muzeun të gjallë në të ardhmen.





BIBLIOGRAFIA

- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). (2023). *Mësimi i kombinuar në lëndën e gjuhës së huaj*. <https://www.ascap.edu.al/mesimi-i-kombinuar-ne-lenden-e-gjuhes-se-huaj/>
- ASCAP. (2023). *Udhëzues për lëndën e gjuhës shqipe – Arsimi bazë*. <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/04/GJUHE-SHQIPE-UDHEZUESI-AB-2023-2.pdf>
- ASCAP. (2023). *Udhëzues për lëndën e gjuhës shqipe – Arsimi i mesëm i lartë*. <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/04/GJUHE-SHQIPE-UDHEZUESI-AML-2023.pdf>
- ASCAP. (2025). *Korniza kurrikulare e miratuar (2024)*. <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Korniza-Kurrikulare-e-miratuar-2024.pdf>
- ASCAP. (n.d.). *Kurrikula*. <https://www.ascap.edu.al/kurrikula/>
- Urdhër Nr. 31, datë 28.01.2020 – Rregullore për IAP. <https://www.ascap.edu.al/udher-nr-31-date-28-01-2020-rregullore-per-iap/>
- Udhëzimi Nr. 17, datë 05.07.2022 – Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar. <https://arkiva.arsimi.gov.al/udhezim-nr-17-date-05-07-2022-per-vleresimin-e-nxenesve-ne-sistemin-arsimor-parauniversitar/>
- Best Project Ideas. (2024). *Income-generating project ideas (PDF)*. <https://bestprojectideas.com/wp-content/uploads/2024/07/Income-Generating-Project-Ideas.pdf>
- ERIC. (2017). *[Titulli i plotë i raportit ose artikullit]*. ERIC. <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED575743.pdf>
- Mindset and Milestones. (n.d.). *75 unique ideas for class projects*. <https://www.mindsetnmilestones.com/75-unique-ideas-for-class-projects/>
- OECD. (2019). *PISA 2018 reading literacy framework (final)*. OECD Publishing. <https://www.oecd.org/pisa/pisa-2018-reading-literacy-framework-final.pdf>
- OECD. (2025). *PISA 2025: Learning in the digital world*. OECD. <https://www.oecd.org/en/topics/sub-issues/learning-in-the-digital-world/pisa-2025-learning-in-the-digital-world.html>

